



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

**Tema:**

*“Barra e provës në procedurën kontestimore dhe natyra juridike e rregullave mbi barrën e provës”*

**KANDIDATI:**

**Burim Koro**

**MENTORI:**

**Doc.D-R.Emine Zendeli**

**Tetovë, Janar, 2018**

# PËRMBAJTJA

Deklarata e autorësisë.....	5
Falënderime.....	6
Shkurtesat – Ankrnimet.....	7
1. Hyrje.....	8
2. Qëllimi i hulumtimit.....	10
3. Hipotezat e hulumtimit.....	10
4. Metodat e hulumtimit.....	11
5. Rëndësia e tezës.....	11
<b>KAPITULLI I.....</b>	<b>12</b>
1. Kuptimi i përgjithshëm i të provuarit.....	12
2. Ndarja - Klasifikimi i provave.....	16
3. Barra e provës.....	17
4. Barra Evidenciale.....	22
5. Barra e bindjes dhe prodhimit.....	23
5.1 Barrja e bindjes.....	24
5.2 Barra e prodhimit.....	25
6. Zbatimi i barrës.....	26
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>28</b>
2. Objekti i provës.....	28
2.1 Faktet kontesuese si objekt i të provuarit.....	29
3. Faktet që nuk kanë nevojë të provohen.....	39
3.1 Faktet e ditura botërisht.....	30
3.2 Faktet e prezumuara nga ligji.....	30
3.3 Faktet e pranuar (të pohuara).....	31
4. Natyra juridike e rregullave mbi marrjen e provës.....	32
5. Qëllimi dhe rëndësia e marrjes së provës.....	34
6. Dispozitat ligjore për marrjen e provës.....	36
7. Barra e të provuarit dhe prezumimet ligjore.....	38

<b>KAPITULLI III</b> .....	42
<b>3. Mjetet provuese</b> .....	42
<b>3.1</b> Procedimi provues.....	44
<b>3.2</b> Koha e paraqitjes së provave.....	45
<b>3.3</b> Marrja e provave.....	46
<b>3.4</b> Çmuarja (vlerësimi) i provave.....	48
<b>3.5</b> Sigurimi i paraprovës.....	49
<b>KAPITULLI IV</b> .....	51
<b>4. Mjetet provuese veç e veç</b> .....	51
<b>4.1</b> Këqyrja drejtëpërdrejt.....	51
<b>4.2</b> Koha dhe vendi i kqyrjes se drejtëpërdrejt.....	51
<b>4.3</b> Provat shkesore (dokumentet).....	52
<b>4.4</b> Llojet e dokumentete provuese.....	53
<b>4.5</b> Fuqia provuese e dokumenteve.....	53
<b>4.6</b> Paraqitja dhe kërkimi i dokumenteve.....	54
<b>4.7</b> Kundërshtimi i vërtetësisë së dokumenteve.....	55
<b>5. Dëshmitarët</b> .....	56
<b>5.1</b> Zotësia për të qenë dëshmitar.....	57
<b>5.2</b> Detyrat e dëshmitarit.....	58
<b>5.3</b> Përfjashtimi nga detyra e dëshmimit.....	58
<b>5.4</b> Pyetjet e dëshmitarëve.....	59
<b>5.5</b> Të drejtat e dëshmitarit.....	60
<b>6. Ekspertët</b> .....	61
<b>6.1</b> Caktimi i ekspertit.....	62
<b>6.2</b> Përfjashtimi i ekspertit.....	63
<b>6.3</b> Ekspertimi.....	64
<b>6.4</b> Përkthyesi dhe interpreti.....	67
<b>7. Palët si mjet provues</b> .....	68
<b>7.1</b> Palët si dëshmitar.....	68
<b>7.2</b> Marrja e provës me anë të dëgjimit të palëve.....	70

Konkluzioni.....	73
Rekomandimi.....	75
Bibliografia.....	76

## **DEKLARATË E AUTORËSISË**

## **Falënderim**

Një falënderim shkon për familjen time, për kurajën dhe mbështetjen që më kanë ofruar në rrugën e gjatë të arsimimit, ku në sajë të tyre gjeta mbështetjen e duhur, të cilët më dhanë gjithë përkrahjen që unë të filloj dhe t'i mbarojë nivelin e dytë të studimeve - master.

Një falënderim shkon për profesoreshën e nderuar, Doc.D–R. Emine ZENDELI, për mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë gjithë punës sime në finalizimin e këtij punimi të diplomës, me këshillat, konsultimet dhe rekomandimet e saj.

## **Shkurtesat – Ankronimet**

- KPCRSH - Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë
- LPK - Ligji për Procedurën Kontestimore i Kosovës
- LFK - Ligji për Familjen i Kosovës
- LMDRK - Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Republikës së Kosovës.
- LPDTSK - Ligji për Pronësi dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës

## 1. Hyrje

Çelësi i suksesit në procedurën kontestimore është përmbushja e barrës së provës. Barra e provës (*latinisht: onus probandi*) është detyrë e një pale në gjykim që të paraqesë provat që do të vërtetojnë pretendimet që kanë bërë kundër palës tjetër. Barra e provës ka dy komponentë: barrën e prodhimit dhe barrën e bindjes. Barra e prodhimit është obligimi për të paraqitur dëshminë në gjykatë. Barra e bindjes është detyrë për të bindur gjyqtarin e procedurës për një standard të caktuar. Ky standard është thjeshtë një pikë matëse dhe përcaktohet duke shqyrtuar sasinë dhe cilësinë e provave të paraqitura. Përmbushja e barrës së provës do të thotë se njëra palë ka paraqitur prova të mjaftueshme bindëse për të arritur standardin e përcaktuar në barrën e bindjes. Objekt i këtij studimi do të jetë pikërisht barra e provës në procedurën kontestimore dhe natyra juridike e rregullave mbi barrën e provës.

Barrat e provës ndryshojnë, varësisht nga lloji i çështjes që gjykohet. Barra e dëshmisë së paditësit në një çështje civile quhet mbizotërim i provave. Mbizotërimi i provave kërkon që paditësi të paraqesë dëshmi pak më shumë ose pak më të mirë se mbrojtja.

Mbizotërimi i provave është një standard mjaft i ulët, por paditësi ende duhet të prodhojë më shumë prova se mbrojtja. Nëse paditësi ofron dëshmi të cilësisë së diskutueshme, gjyqtari mund të konstatojë se barra e provës nuk është plotësuar dhe paditësi e humbë rastin. Paditësi në përgjithësi e ka barrën e vërtetimit të rastit, duke përfshirë çdo element të tij. Gjykuesi i fakteve përcakton nëse një palë e ka përmbushur barrën e provës në gjykim. Barra e provës bie zakonisht mbi personin që sjell një kërkesë në një mosmarrëveshje. Shpesh shoqërohet me maksimen latine "*semper necessitas probandi incumbit ei qui agit*" e cila gjithmonë duhet të jetë i pranishëm në këtë kontekst: "domosdoshmëria e provës gjithmonë qëndron tek personi që akuzon" Pala që nuk bartë barrën e provës e ka përfitimin e supozimit se është e saktë, ato supozohen të jenë të sakta, deri sa barra të ndryshojë pas paraqitjes së provave nga pala që e sjell veprimin.

Nga ato që u thanë më lartë, konsideroj se me shqyrtimin dhe analizimin çështjeve me rëndësi për barrën e provës në procedurën kontestimore dhe natyrën juridike të rregullave mbi barrën e provës, do të jepet një kontribut i rëndësishëm në shtjellimin e gjithanshëm të tyre dhe me përfundimet që do të nxjerren, do të jepen rekomandime adekuate, zbatimimi i të cilave do të ndihmonte institucionet kompetente që të ndërmarrin reformat e nevojshme në funksionalizimin



dhe forcimin e kornizës ligjore në procedurën civile rreth barrës së provës dhe natyrës së saj juridike.

Lëndë e këtij hulumtimi do të jetë analiza e normave juridike që rregullojnë veprimet kryesore të cilat i kryen gjykata, të cilat kanë për qëllim zbulimin e së vërtetës rreth çështjes së caktuar në kontest juridiko – civile, andaj përcaktimi se cila palë e bartë barrën e provës kërkon marrjen në konsideratë të natyrës substanciale të shkaktarit të veprimit të paditësit dhe mbrojtjes së disponueshme në vend të vetëm të përdorimit të formës në të cilën janë përcaktuar rregullat ligjore ose shkaqet e veprimeve të krijuara. Të provuarit në përgjithësi është institut shumë i rëndësishëm i së drejtës civile, për identifikimin e elementeve të cilat e përbëjnë objektin e të provuarit të cilat mund të jenë prova që nuk janë paraqitur nga palët.

Prandaj, ky hulumtim ka për qëllim të japë një shpjegim se ku barra e provës qëndron në lidhje me disa nga çështjet kryesore që zakonisht lindin në çështjet civile, një analizë të faktorëve që çojnë në vendosjen e barrës në një palë dhe jo në tjetrën, dhe një llogari të standardit të provës që duhet të plotësohen në çështjet civile. Për arsye se, provat janë ato që mbulojnë barrën e provës, pranueshmërisë, rëndësisë, peshës dhe mjaftueshmërisë së asaj që duhet të pranohet në procesverbalin e një procesi gjyqësor në çështje civile.

Duke e parë një situatë të tillë e cila po mbretëron në shoqërinë tonë, ky hulumtim do të përfshijë analizën e detajuar në kornizën ligjore që në mënyrë të plotë e rregullon çështjen e parashtrimin të fakteve dhe propozimit të provave me qëllimin e provimit të tyre. (LPKRK - Ligji për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës, 30 qershor, 2008).

Andaj, si lëndë e këtij hulumtimi do të jetë pikërisht analiza e barrës së provës, dispozitave ligjore të marrjes së provave, barra dhe objekti i të provuarit, mjetet provuese dhe çmuarja e tyre të cilat janë të paraqitura nga palët dhe natyrës së rregullimit të normave juridike që rregullojnë përgjegjësinë juridike-civile, si një institut shumë i rëndësishëm i të drejtës së civile.

Poashtu, duke e parë një situatë të tillë e cila mbretëron në shoqërinë tonë hulumtimi im do të përfshijë analizën e detajuar të kornizës ligjore që rregullon përgjegjësinë e paraqitjes së barrës së provës për të provuar në një proces gjyqësor juridiko-civile. Edhe sipas sistemit tonë procedural në Republikën e Kosovës, barra e provës nuk mund të trajtohet si detyrë eskuzive e

palëve, sepse rolin aktiv në zbulimin e së vërtetës materiale gjykata mund ta luajë vetëm në qoftë se ngarkohet me detyrë që saktësisht ta vërtetojë gjendjen faktike, po që nevoja edhe duke marrë prova të cilat nuk i kanë propozuar palët.

Në këtë studim do të përpiqem që të shpjegoj rëndësinë e provës, klasifikimit, natyrën juridike të rregullave mbi marrjen e provës, dispozitat ligjore për marrjen e provës, barra e të provuarit dhe rregullat për prezumimet ligjore, objektit të provës, pretendimet faktike si objekt i të provuarit, faktet kontesuese si objekt i të provuarit, faktet që nuk kanë nevojë të provohen, rastet në të cilat gjykata nuk merr prova për provimin e fakteve kontestuese. Ndërsa rëndësi të posaçme do t'i jap mjeteve provuese si procedimit provues, marrjes së provës, çmuarjes dhe sigurimit të saj poashtu, pa i lënë anash edhe mjetet provuese veç e veç duke i analizuar një nga një.

## **2. Qëllimet e hulumtimit**

Qëllimi themelor dhe kryesor i këtij punimi – hulumtimi është që të studiojë dhe analizojë një çështje të cilës nuk i është kushtuar rëndësi, vëmendje, përkushtim dhe hapësirë të duhur në literaturën shkencore dhe legjislaionin tonë në Republikën e Kosovës.

Andaj, ky hulumtim ka për qëllim të japë një shpjegim se ku barra e provës qëndron në lidhje me disa nga çështjet kryesore që zakonisht lindin në çështjet civile, një analizë të faktorëve që çojnë në vendosjen e barrës në një palë dhe jo në tjetrën, dhe një llogari të standardit të provës që duhet të plotësohen në çështjet civile. Standardi i provës është shkalla ose niveli në të cilin pala që mban barrën e provës duhet të përmbushë atë barrë.

## **3. Hipotezat**

Elementi i dytë i rëndësishëm është hipoteza e studimit, e cila paraqitet në funksion dhe mbështetje të pyetjeve kërkimore. Studimi përpiqet të tregojë vërtetësinë e hipotezës në të gjithë paragrafët e tij. Në mënyrë që t'i jepet një përgjigje pyetjes kërkimore dhe pyetjeve të tjera që ky punim ka për qëllim të shqyrtimit, hipoteza kryesore mbështetet mbi premisën se përafrimi i

legjislaconit të brendshëm që rregullon rrjedhën e procedurës civile si dhe procedurën e barrës së provës dhe objektin e saj.

Për të analizuar këtë çështje kemi ngritur fillimisht disa pyetje kërkimore të cilat janë:

1. Çfarë është prova dhe barra e provës?
2. Roli dhe rëndësia e provës?
3. Kush e bënë çmuarjen – vlerësimin e provave?
4. A duhet të provohen të gjitha pretendimet faktike të cilat janë si objekt i te provuarit?
5. Dipozitat me të cilat rregullohet marrja e provës, a janë të mjaftueshme këto dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi?

Studimi në këtë fushë ka karakter studimor dhe synon të evidentojë risitë që ka pasur barra e provës.

#### **4. Metodologjia e hulumtimit**

Gjatë këtij punimi është aplikuar metodologjia bashkëkohore shkencore, kërkimore, krahasuse, statistikore, analiza dhe sinteza pra janë përdorur disa metoda hulumtimi, varësisht nga nevojat në pjesë të caktuara të punimit për analizë dhe definim të qartë përmes të cilës është përshkruar kuptimi i provës, historikut të saj, barra e provës dhe objekti i të provuarit, procedurat me të cilat është e rregulluar indirekt barra e provës, etj.

#### **5. Rëndësia e punimit**

Rëndësia në këtë punim është, provat, barra e të provuarit dhe procesi i tyre është mjaft i rëndësishëm dhe i ndjeshëm për të ardhur deri tek konstatimi i të vërtetës. Andaj, me hulumtimin e kësaj teme do të jepet një kontribut i rëndësishëm në shtjellimin e gjithanshëm të tyre dhe me përfundimet që do të nxjerrën, do të jepen rekomandime adekuate, zbatimi i të cilave do të ndihmonte institucionet kompetente që të ndërmarrin reformat e nevojshme në funksionalizimin dhe forcimin e kornizës ligjore për provat në përgjithësi, procesin dhe objektin e të provuarit, barrën e provës, mjetet të cilat duhet të provohen etj.

## KAPITULLI I

### 1. Kuptimi i përgjithshëm i të provuarit

Veprimet kryesore të cilat i sjellë gjykata kanë për qëllim zbulimin e së vërtetës rreth çështjes në kontest, dhe çdo gjykim për zbulimin e kësaj të vërtete nuk është gjë tjetër, veçse një proces njohjeje. Procesi gjyqësor është në radhë të parë një proces njohjeje. Të njohësh një send apo një ngjarje, do të thotë të njohësh edhe anën e jashtme (shfaqjen) edhe anën e brendshme (thelbin) të saj. Në këtë kuptim përcaktohen dy shkallët e njohjes: njohja racionale apo mendimi abstrakt dhe njohja empirike apo soditja e gjallë. Këto dy metoda të njohjes janë të lidhura midis tyre si dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Në procesin gjyqësor njohja racionale është më kryesorja jo vetëm për faktin se nëpërmjet saj arrihet të zbulohet brendia, thelbi i sendeve dhe fenomeneve, por edhe nga fakti se në të shumtën e rasteve gjykata njihet me faktet që i përkasin të kaluarës.

Njohja empirike realizohet nëpërmjet kontaktit të drejtëpërdrejtë me një send apo ngjarje, që perceptohet nëpërmjet organeve të shqisave, të cilat janë fillimi dhe burimi i çdo njohjeje. Por veprimtaria e ndërlikuar njerëzore kërkon që njeriu të futet më thellë në thelbin e sendeve dhe fenomeneve, prandaj konstatimi vetëm i anës së jashtme të tyre, nuk është i mjaftueshëm. Faktori i rëndësishëm, thjeshtë njerëzor, që e lejon zbulimin e thelbit të brendshëm të sendeve dhe fenomeneve, ligjet e zhvillimit të tyre, është mendimi abstrakt apo njohja racionale. Ndarja midis këtyre dy metodave të njohjes është relative dhe e pranueshme vetëm për kuptimin e procesit të njohjes, sepse në të vërtetë soditja e gjallë dhe mendimi abstrakt përbëjnë një unitet dialektik, e plotësojnë reciprocisht njëri – tjetrin dhe lindin mbi bazën e praktikës. Kështu, sepse rruga dialektike e njohjes të së vërtetës, e njohjes së realitetit objektiv është: nga soditja e gjallë te mendimi abstrakt dhe prej tij në praktikë.<sup>1</sup>

Nga natyra e saj njohja gjyqësore është më tepër racionale, sepse njohja nëpërmjet kontaktit të drejtëpërdrejtë është e mundur vetëm në lidhje me ato fakte dhe rrethana që ekzistojnë edhe në kohën e zhvillimit të procesit gjyqësor. Të tilla janë faktet dhe rrethanat që mbeten pak a shumë në gjendjen që ishin, si p.sh., pozita e ndërtesës, materiali me të cilin është

---

<sup>1</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 264

ndërtuar ajo, kualiteti i tokës, cilësia e një sendi, si dhe disa fakte juridike të së drejtës procedurale si bije fjala, mosparaqitja e ekspertëve, e dëshmitarëve, e palëve etj.<sup>2</sup>

Njohja racionale nënkupton qënien e tri elementeve: objektit të njohjes, mjeteve me anë të të cilave realizohet njohja dhe vetë procesi i njohjes. Siç u cekë edhe më lartë edhe njohja gjyqësore, që është në të shumtën e rasteve racionale, nënkupton ekzistimin e objektit të provës, mjetit provues dhe të vetë procesit të vërtetimit gjyqësor. Objekt i provës janë ato fakte juridike vërtetësinë e të cilave duhet ta zgjidhë gjykata, si kusht për dhënien e një vendimi të drejtë. Ndërsa provat gjyqësore janë mjetet e parashikuara në ligj për konstatimin e të dhënave faktike dhe përcaktimin e vërtetësisë së fakteve juridike që përbejnë objektin e provës. P. sh. Dëshmitari, shkresa e thjeshtë etj. Si dhe, procesi i vërtetimit gjyqësor është konstatimi i vërtetësisë së marrëdhënies juridike me anë të provave gjyqësore. E thënë më thjeshtë, procesi i vërtetimit gjyqësor është konstatimi i objektit të provës si element i parë i njohjes gjyqësore, me anë të provave gjyqësore si element i dytë. Lidhur ngushtë me këto elemente në procedimin provues, janë nocionet e fuqisë provuese, argumenteve provuese dhe e barrës së provës. Fuqia provuese (*nervus probationis*) e mjetit provues (p.sh. e dokumentit) është aftësia e një prove për të krijuar bindjen te gjykata për vërtetësinë apo pavërtetësinë e faktit në kontestim. Argumentet provuese (shkaqet) janë përfundimet lidhur me përmbajtjen dhe cilësinë e të dhënave të dala nga mjeti provues. Barra e provës (*onus probandi*) është përcaktimi i palës në proces e cila duhet të provojë faktin e pretenduar me mjetet provuese.<sup>3</sup>

Zbatimi i normave juridike, qofshin ato materiale apo procedurale, mund të bëhet në mënyrë të drejtë vetëm në qoftë se konstatohet saktësisht edhe plotësisht gjendja faktike në të cilën palët i bazojnë kërkesat e tyre. Sipas së drejtës sonë procedurale sikurse konstatimi i gjendjes faktike ashtu edhe të provuarit është detyrë e përbashkët e gjykatës dhe e palëve ndërgjyqëse. Me anë të provuarit pala mund ta bind gjykatën në saktësinë e fakteve për të cilat e mbështet ndonjë kërkesë të saj materialo – juridike apo proceduralo – juridike, kurse gjykata e verifikon saktësinë e tyre, por edhe të fakteve që duhet t'i konstatojë *ex officio*. Duhet të provohen vetëm faktet relevante (të rëndësishme në rastin konkret). Ekzistimi i tyre, e në disa raste edhe mosegzistimi i tyre, bëhet me anë të të provuarit. Të provuarit (*argumentation, demonstratio*) e përbejnë veprimet procedurale të subjekteve kryesore me të cilat bëhet

---

<sup>2</sup> Po aty, fq. 265.

<sup>3</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 266

propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe çmuarja e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështeten kërkesat e palëve.<sup>4</sup> Me anë të të provuarit gjykata e grumbullon materialin faktik i cili e përbën premisën e vogël (*premissae minor*) të silogjizmit gjyqësor. Duke zbatuar normën juridike (*premissae maior*) në gjendjen faktike të konstatuar gjatë procesit gjykata e jep vendimin i cili është rezultat i raportit të dy premisave të përmendura.

Faktet që kanë qenë objekt i të provuarit gjykata i merr për themel të vendimit të saj vetëm në qoftë se janë paraqitur të sakta. Kjo cilësi mund t'i ketë dy shkallë të intensitetit. Shkallën më të lartë e përbën bindja (siguria) e gjykatës se ekziston fakti i përmbajtjes së caktuar që ka qenë objekt i të provuarit, përkatësisht se nuk ekziston fakti i tillë. Bindja në vërtetësi duhet të ekzistojë te gjykata për t'u marrë si të provuara faktet nga të cilat varet vendimi për themelësinë e kërkesëpadisë – të cilin ajo e jep duke zbatuar normën materialo – juridike. Ndërsa, shkallën më të ulët e përbën besueshmëria se është i mundur ekzistimi i faktit të përmbajtjes së caktuar që ka qenë objekt i të provuarit, përkatësisht se nuk ekziston ai. Kjo shkallë e intensitetit vjen në shprehje kur është fjala për faktet nga të cilat varet vendimi lidhur me kërkesën procedurale të palës – të cilin ajo e jep duke zbatuar normën proceduralo - juridike.

Gjykata ka detyrë që ta shqyrtojë çdo kërkesë procedurale – juridike dhe të vendosë për të. Kërkesën e tillë gjykata e refuzon në qoftë se konstaton se është e pathemeltë në aspektin proceduralo – juridik, përkatësisht e pranon atë në qoftë se është e themeltë në aspektin e tillë.<sup>5</sup> Për të pranuar kërkesën procedurale – juridike të pjesëmarrësit në gjykim zakonisht mjafton që të bëhen të besueshme arsyet që flasin në favor të pranimit të saj. Si raste në të cilat gjykata nuk ka detyrë që me prova të bindet në saktësinë e fakteve mund të përmenden: delegimi, përjashtimi i gjyqtarit<sup>6</sup>, zgjatja e afatit gjyqësor, shtyrja e seancës<sup>7</sup>, kthimi në gjendjen e mëparshme<sup>8</sup>, pranimi i kërkesës për kaucionin aktorial, pranimi i kërkesës për lirimin nga pagimi paraprak i shpenzimeve gjyqësore<sup>9</sup>, pranimi i kërkesës për emërimin e përfaqësuesit pa pagesë, pranimi i propozimit për sigurimin e provës - paraprovë<sup>10</sup>, pranimi i kërkesës për lirimin nga detyra e

---

<sup>4</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 267

<sup>5</sup> Po aty, fq. 268

<sup>6</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), neni 67

<sup>7</sup> Po aty, neni 123

<sup>8</sup> Po aty, neni 129

<sup>9</sup> Po aty, neni 468

<sup>10</sup> Po aty, neni 379

dhënies së deklaratës si dëshmitar<sup>11</sup>, ekzistimi i arsyeve për komunikimin nëpërmjet tabelës në gjykatë kur nuk dihet adresa e re e palës.<sup>12</sup>

Kur prova merret me qëllim që një rrethanë të bëhet e besueshme, gjykata nuk është e lidhur me rregullat për formën e paraparë për marrjen e provave me qëllim të provimit të fakteve që duhet të shërbejnë si bazë për vendimin merititor. Kështu p.sh. për konstatimin e besueshmërisë së një fakti gjykata kënaqet edhe po qe se pala e paraqet deklaratën me shkrim të dëshmitarit për vërtetësinë e një fakti relevant që do të merret për një themel të vendimit për ndonjë çështje procedurale. I tillë mund të jetë, p.sh., rasti në të cilin vendoset për kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Derisa të të provuarit me qëllim që gjykata të bindet për ekzistimin e një fakti duhet marrë parasysh si arsyet që flasin për, ashtu edhe ato që flasin kundër, të provuarit me qëllim të sjelljes deri të besueshmëria mund të merren parasysh vetëm arsyet që flasin në favor të dhënies së vendimit me të cilin pranohet kërkesa procedurale e palës. Nga kjo që u tha mund të përfundohet se bërja e faktit të besueshëm është aktivitet procedural që i përket zakonisht vetëm palës që e ka propozuar dhënien e vendimit procedural, e jo edhe kundërshtarit të saj. Andaj, aktiviteti i tillë mund të kryhet edhe pa qenë e pranishme pala kundërshtarë.

Prandaj, kur është fjala për veprimet procedurale jo aq të rëndësishme gjykata as që duhet që ta zhvillojë procedurën provuese, me qëllim që ekzistimi i një rrethane të bëhet i besueshëm. Në rast të tillë, gjykata mund ta pranojë kërkesën procedurale të palës vetëm në bazë të thënieve të saj me të cilat i përmend faktet relevante dhe i ofron mjetet provuese adekuate, me të cilat mund të provohet ekzistimi i tyre.

Në bazë të asaj që u tha më lartë mund të themi se, për këtë shkallë të të provuarit, nuk është i domosdoshëm arsyetimi i vendimit procedural. Mjafton që në të gjykata vetëm t'i përmendë burimet nga të cilat ka marrë njohuri në bazë të të cilave ka përfunduar se është i vërtetë pretendimi i palës për ekzistimin e fakteve në të cilat ajo e ka bazuar kërkesën procedurale.<sup>13</sup>

---

<sup>11</sup> Po aty, neni 345

<sup>12</sup> Po aty, neni 116, par. 5.

<sup>13</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 269

## 2. Ndarja - klasifikimi i provave

Siç u tha më sipër provat janë ato mjete të parashikuara në ligj, të cilat shërbejnë për të konstatuar faktet gjatë procesit gjyqësor dhe mbi këtë bazë për të zgjidhur në bazë të ligjit mosmarrëveshjet juridike civile. Provat janë të ndryshme dhe si të tilla mund të ndahen sipas disa kriterëve të paracaktuara në disa kategori. Duke u nisur nga ndarja më e përgjithshme, provat ndahen sipas burimeve të tyre të parashikuara në ligj, pohimet e paditësit, të paditurit e personit të tretë, thëniet e dëshmitarëve, shkresat, dhe provat materiale. Teoria ka bërë ndarjen e provave sipas disa kriterëve për efekt studimi dhe për të lehtësuar vlerësimin e tyre. Kështu një kriter i ndarjes së tyre është cilësia e burimit të tyre. Provat që kanë prejardhjen nga personat fizikë e juridikë, si palët, personat e tretë, dëshmitarët, ekspertët. Këto janë quajtur prova personale.<sup>14</sup> Ndërsa provat burimi i të cilave janë sendet e botës materiale që ruajnë mbi vete gjurmë të veprimeve të caktuara ose vetë përbënjë gjurma të fakteve e ngjarjeve me vlerë për gjykatën. P.sh. një dokument i zbuluar, një objekt që kqyret nga gjykata si murri, gurët etj. Mbi provat materiale gjykata merr njoftim të drejtpërdrejtë, ndërsa provat personale i njoftohen gjykatës nga personat e tjerë.

Sipas kohës së formimit provat dallohen në prova të formuara më përpara, siç është p.sh. shkresa dhe në prova që formohen gjatë procesit gjyqësor si dëgjimi i dëshmitarëve, pohimi i palëve etj. Sipas kriterit të mënyrës së formimit provat ndahen në kryesore dhe rrethanore. Kryesore janë ato prova që dalin nga burimi i parë si p.sh. thëniet e dëshmitarit që e ka parë ngjarjen me sy, shkresa zyrtare origjinale, kqyrja e vendit ku ka ndodhur një ngjarje etj. Rrethanore ose të tërthorta janë ato prova kur lidhja midis faktit që kërkohet të provohet dhe provës nuk është e drejtpërdrejtë, por e tërthortë. P.sh. dëshmitari për ato që deklaroi në gjyq nuk i ka parë me sy apo dëgjuar vetë, por i ka mësuar nga vetë pala ndërgjyqëse ose nga një person i tretë. Bie fjala dëshmitari deklaroi se nuk ka qenë i pranishëm kur paditësi ia ka dorëzuar të paditurit sendin, por këtë fakt e ka mësuar nga paditësi ose i padituri. Duket qartë se më të rëndësishme dhe bindëse janë provat kryesore ose të drejtpërdrejta.<sup>15</sup>

Provat rrethanore ose indirekte nuk mund të mos përfillin ose përdoren nga gjykata, pasi një qëndrim i tillë ekstrem nga ana e gjykatës do t'i hiqte atyre karakterin e provës. Por, nga ana tjetër, vetëm në bazë të një prove të tërthortë nuk mund të arrihet në përfundime të bazuara

<sup>14</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 270

<sup>15</sup> Vanderbilt Law Review, "The Nature and Purpose of Evidence Theory", 2013, fq. 547–613.



plotësisht. Në të shumtën e rasteve provat rrethore shërbejnë për të ndihmuar në përforcimin ose kundërshtimin e provave kryesore së bashku me këtë provë. Bie fjala gjykata mund të dyshojë në thëniet e një dëshmitari, të cilat përbëjnë provë direkte, për shkak se megjithëse deklaron se e ka parë ngjarjen me sy, thëniet e tij duhen verifikuar me dëshmitarë të tjerë që nuk kanë qenë të pranishëm, por që kanë marrë dijeni në një mënyrë ose tjetër, pasi dëshmitari okular është i afërm me palën paditëse.

Në këtë mënyrë nga provat rrethore ndihmohet gjykata për të bërë vlerësim të drejtë për provat e drejtpërdrejta për të cilat ajo ka dyshime. Shfrytëzimi i provave rrethore është shumë më i vështirë nga ai i provave të drejtpërdrejta ose kryesore por, megjithatë, është i domosdoshëm për të arritur në përfundime të drejta. Kjo vështirësi shtohet edhe më tepër kur në procesin gjyqësor provat janë vetëm rrethore. Në këto raste kërkohet aftësi në vlerësimin e drejtë të secilës prej tyre veç e veç ashtu edhe të gjithave në tërësi, për të arritur në përfundim të drejtë për faktin juridik të pretenduar. Kundër provës kryesore mund të paraqitet kundërprova nga pala që nuk e ka barrën e provës, me qëllim për të bindur gjykatën se gjendja faktike është e kundërt me atë të pretenduar nga pala tjetër që ka përdorur provën kryesore. Gjykata duhet të lejojë paraqitjen e kundërprovës kur të mos jetë bindur plotësisht në vërtetësinë e pretendimit, për të cilin është përdorur prova kryesore.<sup>16</sup>

### 3. Barra e provës

Termi i barrës së provës rrjedh nga termi latin "*onus probandi*". Barra e provës është detyrimi i vënë një palë për të provuar ose hedhur poshtë një fakt të kontestuar. Barra e provës ose barra e të provuarit (*onus probandi*) është përcaktimi i subjektit (palës) në procesin gjyqësor civil që duhet të provojë faktin (faktet) e pretenduar. Me LPK nuk është e rregulluar në mënyrë të plotë çështja e parashtrimit të fakteve dhe e propozimit të fakteve me qëllim të provimit të tyre. Në nenin 7 par. 1 të LPK, palët kanë për detyrë që në gjykim të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre, si dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Është detyrë e palëve në proces për të paraqitur pretendimet lidhur me faktet në të cilat i mbështesin kërkesat e tyre, si dhe provat me të cilat mund të vërtetohen këto pretendime. Ky

---

<sup>16</sup> Pardo, M.S. and R.J. Allen, 2008, "Juridical Proof and the Best Explanation", Law and Philosophy, fq. 223–268.

rregull zbatohet si për kërkesëpadinë e paditësit ashtu edhe për prapësimet me të cilat i padituri mbrohet nga padia. Pikërisht këto detyrime të palëve në teori janë quajtur barra e provës. Provat zakonisht tregohen nga palët, paditësi në padi i tregon provat me të cilat mund të vërtetohet themelësia e kërkesëpadiës, kurse i padituri në përgjigje në padi ose gojarisht në seancë gjyqësore i tregon provat me të cilat verifikohen prapësimet ndaj kërkesëpadiës. Në qoftë se paditësi gjatë gjykimit e ka provuar shkakun e padisë, nga ai nuk mund të kërkohet që të provojë edhe faktet që e bëjnë të papranueshëm prapësimin e të paditurit. Fakti se është shlyer një detyrim i jep të drejtë të paditurit që ta parashtrijë prapësimin me qëllim që të vërtetojë se është shuar detyrimi që ka ekzistuar me parë. Në këtë rast ky fakt duhet të provohet.<sup>17</sup>

Në sistemin tonë procedural të Republikës së Kosovës, barra e provës nuk trajtohet si detyrë ekskluzive vetëm e palëve, sepse rolin aktiv në zbulimin e së vërtetës materiale (objektive) gjykata mund ta luaj vetëm në qoftë se ngarkohet me detyrë që saktësisht ta vërtetojë gjendjen faktike, po qe nevoja edhe duke marrë prova të cilat nuk i kanë propozuar palët. Këtë detyrë e ka paraparë edhe neni 7 par 2<sup>18</sup> dhe neni 320 (në aspektin e gjendjes faktike) dhe neni 7 (në aspektin e provave).<sup>19</sup> Nga ajo që u tha më lartë, arrihet në përfundimin se detyrimi i palëve për të provuar faktet në të cilat i mbështesin kërkimet ose prapësimet e tyre nuk e mënjanojnë kursesi gjykatën që të përcaktojë rrethin e atyre fakteve që e përbëjnë objektin e provës, të ndihmojë palët në paraqitjen e provave dhe, kur provat e paraqitura nga ato nuk janë të mjaftueshme, ashtu sikurse janë të përcaktuar në nenin 7 par. 2 të LPK-së, t'i marrë edhe provat që nuk i kanë propozuar palët. Andaj, kjo e drejtë dhe detyrë e gjykatës është e domosdoshme, sepse jo rrallë ndodh që palët nga mosnjohja e ligjit u referohen vërtetimit të disa fakteve që nuk kanë rëndësi ligjore dhe lënë jashtë qendrës së vëmendjes faktë të tilla, që kanë shumë rëndësi për zgjidhjen e kontestit. Gjykata është e detyruar t'i korrigjojë gabimet e tilla duke iu referuar përmbajtjes së normave të së drejtës materiale me të cilat rregullohen marrëdhëniet juridiko – civile nga të cilat lindin kontestet. Nga këto dispozita ligjore rezulton se vetëm përjashtimisht gjykata ka të drejtë dhe detyrim që të ofrojë fakte ose të merr prova, që nuk i kanë paraqitur palët, nëse kemi të bëjmë me veprimet që i referohen kërkesave me të cilat palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

---

<sup>17</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 271

<sup>18</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 7;

<sup>19</sup> Po aty, neni 320

*P.sh. “Nëse subjekti X ka paraqitur padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë pranë gjykatës kompetente, kundër të paditurit subjektit Y, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i padituri e pohon kërkesën e padisë së paraqitur nga paditësi, mirëpo nga rezultati i shqyrtimit gjykata vlerëson se bëhet fjalë për kërkesën, të cilën i padituri nuk mund të disponojë lirisht pasi që prona kontestuese nuk figuron si pronësi e të paditurit. Në këtë rast gjykata ka detyrim që të ketë rol aktiv të hetimit, me qëllim që të konstatojë nëse kërkesa e padisë është kërkesë e disponueshme për palët ndërgjyqësore. Për të konstatuar këtë rrethanë gjykata zyrtarisht mund të marrë edhe prova si p.sh: kërkimi i certifikatës së pronësisë nga organi kompetent, këqyrja në vend apo dëgjimi i dëshmitarëve etj.”<sup>20</sup>*

Duhet theksuar faktin se sipas LPK-së veprimet kryesore të cilat i kryen gjykata sipas propozimit të palëve në procesin e të provuarit kanë për qëllim që të zbulohet e vërteta përkatësisht që të arrihet e vërteta e provuar. Pra nuk kërkohet të arrihet te e vërteta absolute por te e vërteta e provuar. Në këtë kontest duhet theksuar se i tërë aktiviteti i gjykatës duhet të jetë fokusuar në drejtim të arritjes së të vërtetës së provuar, por me që barra e të provuarit sipas LPK-së, bie mbi palët atëherë gjykata mund të arrijë te e vërteta e provuar në qoftë se palët e kontestit i paraqesin faktet dhe provat e duhura për çështjen që është objekt i shqyrtimi dhe vendosjes.

Me rëndësi themelore në këtë proces, është që gjyqtarët të gjitha veprimet që i ndërmarrin në një çështje shqyrtimi t’i ndërmarrin sipas kompetencës që kanë për çështjen, në pajtim me ligjin dhe me paanësi.<sup>21</sup>

Kur, nga provat e paraqitura nga vetë palët ndërgjyqëse, si dhe me provat e marra nga gjykata *ex officio*, nuk vërtetohet themelësia e kërkesëpadisë apo e prapësimit atëherë gjykimi nuk mund të përfundojë në favor të palës pretendimi i së cilës nuk është vërtetuar. Kështu në qoftë se nuk provohen faktet në të cilat bazohet kërkesa e paditësit, padia e tij do të refuzohet, në qoftë se nuk provohen faktet në të cilat bazohet prapësimi i të paditurit, prapësimi nuk mund të merret parasysht dhe, për rrjedhim, kur provohet kërkesa e paditësit, vendoset në dëm të të paditurit. Andaj, barra e provës është ana tjetër e medaljes. Meqenëse, paditësi kërkon që nëpërmjet padisë si mjet procedural, të realizojë të drejtën e shkelur ose të mohuar, ai ka barrën e provës që nëpërmjet provave të vërtetojë të drejtën që pretendon. Dhe se kjo e drejtë i është shkelur dhe mohuar nga pala tjetër ndërgjyqëse, pala e paditur. Pra në këtë procedim pala

---

<sup>20</sup> Instituti Gjyqësor i Kosovës, Doracaku i gjyqtarëve për procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2016, fq. 231

<sup>21</sup> Po aty, fq. 232

paditëse është shumë aktive në sjelljen e provave, ajo duhet të vërtetohet, po nëpërmjet këtyre provave të drejtën e shkelur, ndryshe nga personi i dyshuar në procedimin penal ku ai mund të jetë edhe shumë pasiv.<sup>22</sup>

Në teori mbisundon mendimi se rregullat e barrës së provës janë në radhë të parë të karakterit juridiko - materiale, për arsye se determinohen nga dispozitat juridiko – materiale. Nga dispozitat materiale ku mbështetet kërkimi del se cilës palë i bie barra e të provuarit. P.sh. sipas dispozitave që rregullojnë kontratën e huasë, paditësi huadhënës duhet të provojë dhënien e huasë, ndërsa i padituri huamarrës duhet të provojë kthimin e huasë kur paditësi e ka provuar kërkimin e tij. Ose në padinë për kërkimin e sendit, paditësi pronar duhet të provojë se është pronar i sendit që kërkon. Por, megjithatë, rregullat lidhur me pasojat juridike kur nuk provohen kërkimet dhe pretendimet e palës kanë karakter procedural, të cilat shfaqen në procesin gjyqësor. Kështu, nga shembujt e mësipërm themi se kur paditësi huadhënës nuk provon dhënien e huasë ose paditësi pronar nuk provon të drejtën e pronësisë mbi sendin, rrëzohet padia, që do të thotë se pasojat juridike janë të karakterit procedural.<sup>23</sup>

Në praktikë jo kurdoherë është e lehtë të dallohet se cilës palë i bie barra e të provuarit të një fakti të caktuar, sidomos atëherë kur në dispozitat ligjore materiale nuk është e shprehur, si në shembujt e mësipërm. Për të dalluar se cili nga ndërgjyqësit duhet të provojë një fakt, d.m.th. se cilit i bie barra e provës, ndihmon shumë ndarja e fakteve në fakte formues, pengues dhe shues. Fakte formues ose konstitutive janë ato fakte që sjellin me vete lindjen e një të drejte. P.sh. e drejta për të marrë çmimin nga shitja e një sendi; e drejta për të marrë pasurinë që rrjedh nga trashëgimia. Faktet formues duhet të provohen nga pala që i pretendon, që zakonisht është paditësi. Fakte pengues janë ato fakte që pengojnë lindjen e një të drejte. P.sh. kryerja e veprimit juridik me mashtrim ose me kanosje, keqbesimi në posedimin e sendit. Zakonisht këto fakte pretendohen nga i padituri, por mund të pretendohen edhe nga paditësi. Prandaj themi se i takon barra e provës atij që i pretendon. Fakte shues janë ato fakte që sjellin me vete shuarjen e një të drejte. P.sh. pagimi i çmimit për sendin e blerë, kthimi i huasë. Edhe këto fakte zakonisht i pretendon i padituri, prandaj i takon atij edhe barra e provës. Vështirësia kryesore qëndron në dallimin nëse fakti është formues apo pengues. Për të kapërcyer këtë vështirësi duhet të bëhet dallimi midis kushteve të nevojshme për qënien e një marrëdhënie juridike. Kur këto kushte janë

---

<sup>22</sup> Instituti Gjyqësor i Kosovës, Doracaku i gjyqtarëve për procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2016, fq. 233

<sup>23</sup> Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë, 2010, fq. 121.

specifike (të veçanta) për një marrëdhënie juridike të caktuar, kemi të bëjmë me fakte formuese. P.sh. në kontratën e shitjes marrëveshja për çmimin dhe sendin, si dhe akti material kur sendi është i paluajtshëm; ose në kontratën e huasë marrëveshja për shumën e dhënë hua dhe afati i kthimit të huasë, janë kushte specifike të shitjes e huasë dhe si të tilla përbëjnë fakte formues.<sup>24</sup>

Disa kushte të tjera janë të përbashkëta për marrëdhënie juridike të ndryshme, si zotësia për të vepruar, vullneti i lirë për të kryer veprimin juridik etj. kur këto mungojnë përbëjnë fakte penguese. Nga ky dallim i kushteve në marrëdhënien juridike, në kushte specifike dhe të përgjithshme del përfundimi tjetër se kushtet e përgjithshme të shumë marrëdhënies juridike zakonisht ekzistojnë në të gjitha këto marrëdhënie (zotësia për të vepruar), është përjashtim; ndërsa kushtet specifike të një marrëdhënie juridike nuk janë në të gjitha marrëdhëniet juridike, kështu që qenia e tyre nuk është rregullë dhe si rrjedhojë mungesa e tyre (çmimi në kontratën e shitjes) nuk është përjashtim. Pikërisht në mbështetje të këtij dallimi të rregullit dhe të përjashtimit nga rregulli, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se duhet të provohen vetëm ato fakte që nuk janë rregull, d.m.th. vetëm ato që janë përjashtim, pra, duhet të provohen vetëm faktet specifike si fakte formues. Ndërsa faktet e përgjithshme ose të zakonshme, që përbëjnë rregullin, nuk duhet të provohen. Andaj, nisur nga ajo se barra e të provuarit të fakteve duhet të bazohet në dallimin midis asaj që është e rregullt dhe asaj që përbën përjashtim nga rregulli, del përfundimi se mungesa e fakteve pengues është e përgjithshme dhe si e tillë përbën rregullin, ndërsa ekzistenca e fakteve pengues është përjashtim, prandaj, kur pretendohet qenja e kushtit ose faktit pengues nga i padituri, atij i bie barra e provës për qenjen e faktit pengues. Marrim si shembull kontratën e shitjes së një sendi të luajtshëm. Kur sendi i shitur është me të meta, blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi, ndër të tjerë, ndërrimin e sendit me të meta me një send pa të meta ose zbritjen e çmimit. Shitësi nga ana e tij pretendon se blerësi i dinte këto të meta në kohën e blerjes së sendit.<sup>25</sup>

Duke u nisur nga dallimi i kushteve fakte që përbëjnë rregullin nga kushtet që përbëjnë përjashtim, nxirret përfundimi se mungesa e të metave të sendit përbën rregullin, prandaj ato duhet t'i provojë blerësi që i pretendon si përjashtim. Po ashtu pretendimi për dijeninë e të metave përbën përjashtim dhe këtë fakt duhet ta provojë shitësi që e pretendon, për arsye se si rregull i përgjithshëm blerësi nuk i di të metat e sendit. Ose në marrëdhëniet e trashëgimisë,

---

<sup>24</sup> Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë, 2010, fq. 122

<sup>25</sup> Po aty, fq. 123

trashëgimtari nuk është i detyruar të provojë zotësinë për të vepruar të trashigimlënësit të tij që ka lënë testament apo zotësinë e vet për të trashëguar, por vetëm lidhjen e gjinisë dhe ekzistencën e testamentit. I takon palës tjetër që pretendon të provojë pazotësinë për të vepruar të trashëgimlënësit apo pazotësinë për të trashëguar të trashëgimtarit.

Lidhur me faktet shuese, siç u tha më sipër barra e të provuarit si rregull i përket të paditurit. Ky duhet të provojë ekzekutimin e detyrimit që përbën fakt shues. Por lidhur me ekzekutimin e detyrimeve duhet të bëhet dallimi midis detyrimeve pozitive e negative, d.m.th. midis detyrimeve për kryerjen e një veprimi dhe detyrimeve për moskryerjen e një veprimi. Në detyrimet për kryerjen e një veprimi paditësi duhet të provojë vetëm qënien e detyrimit, p.sh. duhet të provojë dorëzimin e sendit në huapërdorje të paditurit, por jo edhe moskthimin e tij nga ky i fundit.<sup>26</sup>

Ndërsa në detyrimet për mos kryerjen e një veprimi paditësi duhet të provojë qënien e detyrimit për të mos kryer veprimin, si dhe kryerjen e veprimit nga i padituri. P.sh. paditësi duhet të provojë se i padituri detyrohet të mos kalojë nëpër oborrin e paditësit, si dhe kalinin e tij nga ky oborr, si fakt në kundërshtim me detyrimin e të paditurit ( si kusht-fakt i veçantë). Prezumimi ligjor që është analizuar në çështjen e mëparshme, ia lehtëson shumë barrën e të provuarit palës në dobi të së cilës është ky prezumim. P.sh. pagimi i këstit të muajit të mëvonshëm të qirasë së energjisë elektrike prezumon pagimin e muajit të mëhershëm nga ana e përdoruesit.<sup>27</sup>

#### **4. Barra Evidenciale**

Rregull i përgjithshëm në çështjet civile është se pala që ka barrën ligjore gjithashtu ka edhe barrën evidenciale. Në një veprim të neglizhencës, për shembull, paditësi ka barrën ligjore që përfundimisht ta bindë gjykatën për faktin se i padituri detyrohet që për paditësin të kujdeset, i padituri e shkel këtë përgjegjësi dhe i shkakton dëme paditësit. Nëse paditësi nuk e shkarkon këtë barrë ligjore, atëherë padia e paditësit do të dështojë. Pasi që paditësi bartë barrën ligjore në lidhje me këto çështje, ai ose ajo gjithashtu bartë barrën e provës dhe rasti i paditësit do të tërhiqet nga gjykata, përveç nëse ai ose ajo shkarkon këtë barrë. Andaj, barra ligjore për vendosjen e të gjitha elementeve të provave i takon paditësit.

---

<sup>26</sup> Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë, 2010, fq. 124

<sup>27</sup> Po aty, fq. 126

Megjithatë, kur vërtetohet se është bërë një paraqitje e rreme dhe mashtruese, i padituri mban barrën e provës për të treguar se përfaqësimi nuk ishte adekuate dhe i drejtë ashtu siç duhet. P.sh. rasti *Gould vs Vaggelas* ku ankuesit pretendonin se ishin detyruar të lidhnin një kontratë për mashtrim lidhur me anketimin e të anketuarve. Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës konstatoi se, arsyeja e refuzimit të dëshmisë nga paditësi është hedhur tek i padituri, pavarësisht se barra ligjore në lidhje me këtë çështje mbështetet tek ankuesi. Wilson J deklaroi: Kur një paditës tregon se, personi i paditur ka bërë deklaratë të rreme ndaj tij duke synuar që ta shtyjë atë të lidhë një kontratë për mashtrimin e të anketuarëve dhe këto deklaratë të tilla janë natyrës së tillë, për arsye të nxitjes që paditësi të hyjë në të vërtetë në atë kontratë dhe duke pësuar dëme, me hyrjen në kontratë. Prandaj, është e lejuar për të paditurin që të pengojë nxjerrjen e këtij konkluzioni të fakteve duke treguar se, ka pasur rrethana të tjera të rëndësishme. Shembuj të dhënë zakonisht për këto rrethana janë se paditësi jo vetëm që i njihnte faktet e vërteta, por gjithashtu paditësi me fjalët ose me sjelljen e tij e mohoi çdo mbështetje mashtruese. Barra ligjore e provës së zotësisë testamentare mbështetet tek pala që kërkon të marrë vullnetin, barra e provës për të treguar mungesën e kompetencës mbështetet tek pala që sfidon vullnetin.<sup>28</sup> Në ankesat kundër vlerësimeve nga Komisioneri i Tatimeve, tatimpaguesi mban barrën ligjore të provës, ndërsa Komisioneri mban barrën e provës për ngritjen e një çështjeje të caktuar në dëshmi në mënyrë që të kërkojë që tatimpaguesi të merret me këtë çështje.<sup>29</sup>

## 5. Barra e bindjes dhe prodhimit

Një koncept qëndror për të gjitha provat është ai i barrës së provës. Për shpërndarjen e kësaj barre të provës ndërmjet palëve ndërgjyqëse është përkthyer si një "e drejtë e rëndësishme procedurale që mund të ketë konsensus substanciale".<sup>30</sup> Pa marrë parasysh këtë rëndësi, barra e provës gjithashtu është përkthyer herë pas here si një koncept konfuz.<sup>31</sup> Si shkak më i rëndësishëm i konfuzionit që e rrethon barrën e provës dhe aplikimi i tij është kuptimi që gjykata e përkthuan konceptin e vetë të termit të barrës së provës. Gjykata Supreme e SHBA-së e ka

---

<sup>28</sup> *Sutton v Sadler* [1857] EngR 738; (1857) 3 CB (NS) 87; 140 ER 671.

<sup>29</sup> *Coppleston v FCT* [1928] ArgusLawRp 106; (1981) 34 ALR 377.

<sup>30</sup> *Bruner v. Office of Pers. Mgmt.*, 996 F. 2d, 290, 293

<sup>31</sup> *Schaffer v. Weast*, 546 U.S. 49, (2005) *Simpson v. Home Petroleum Corp.*, 770 F.2d 499, 502 (5<sup>th</sup> Cir, 1985).

përcaktuar barrën e provës si barrë e bindjes.<sup>32</sup> Duke vepruar kështu, Gjykata e ka dalluar atë nga prodhimi i ngarkesës, ndonjëherë i referuar si barrë e shkeljes.<sup>33</sup> Megjithatë, disa Gjykata përdorin termin e barrës së provës pa përshkrim të mëtëjshëm kur i referohen barrës së bindjes apo asaj të prodhimit, të cilën ata e konsiderojnë element të ndarjes të barrës së provës.<sup>34</sup> Ende Gjykatat e tjera dallojnë midis tyre duke iu referuar barrës së bindjes si barrë e plotë e provës dhe ajo e prodhimit si barrë fillestare e provës.<sup>35</sup>

Në lidhje me barrën e bindjes dhe prodhimit është i nevojshëm standardi i provës për të vërtetuar faktet e pretendimit të mbrojtjes afirmative në fjalë në raste të veçanta. Për shumicën e kërkesave civile dhe mbrojtjen afirmative të tyre, këto fakte duhet të ekzistojnë me anë të përputhshmërisë së provave, një standard që kërkon gjetjen e faktit të nxjerrë përfundimin nga provat përpara se një fakt në fjalë është më i besueshëm, se jo i vërtetë.<sup>36</sup> Standardi tjetër që nganjëherë zbatohet në çështjet civile, siç janë pohimet për mashtrim apo keqbërje të tjera, është ai i provave të qarta dhe bindëse.<sup>37</sup> Ky standard nuk përmblihet lehtësisht si standardi i mbizotërimit të provave si është përshkruar duke kërkuar gjetjen e faktit për të nxjerrë nga prova e ekzistencës së fakteve të nevojshme me qartësi bindëse.<sup>38</sup>

## 5.1 Barra e bindjes

Barra e bindjes është përcaktuar në disa mënyra, siç është ajo e detyrimit për të bindur faktin që gjykohet në gjykim se pretendimet e nevojshme të palëve për të vërtetën janë të vërteta,<sup>39</sup> ose barrën për të bindur faktorin se ekzistenca e propozimit që do të provohet është shumë e vërtetë.<sup>40</sup>

Gjithashtu është përshkruar si një shkelës i lidhjes, duke diktuar se pala e dytë bartë atë barrë që duhet të humbasë kur gjetësi i fakteve arrinë në përfundimin se provat e para si për një ose më shumë fakte thelbësore të një kërkesë ose mbrojtjeje janë të balancuar në mënyrë të

---

<sup>32</sup> Director, Office of Workers' Comp. Programs v. Greenwich Colliers, 512 U.S. 267, 272 (1994).

<sup>33</sup> Greenwich Colliers, 512 U.S. at 272.

<sup>34</sup> McCann v. Newman Irrevocable Trust, 458 F.3d 281, 287 (3d. Cir, 2006); In re Britt 199 B.R. 1000, 1008 (Bank N.D Ala, 1996).

<sup>35</sup> Samuel v. Ford Motor Co 122 F. Supp. 2d 460, 467 (D.Md. 2000), aff'd, 95 F. App.x 520 (4<sup>th</sup> Cir.2004); Lisbon Contractors, Inc. v. United States 828 F.2d 759,765 (Fed.Cir 1987); In re Anthem Cmty/RGB,LLC,267 B.R,867, 872 (Bank.D.Colo 2001).

<sup>36</sup> Concrete Pipe and Prods. of Cal., Inc v. Constr. Laborers Pension Trust for S.Cal., 508 U.S.602,622 (1993)

<sup>37</sup> Addington V. Texas, 441 U.S 418, 424 (1979)

<sup>38</sup> Andreson v. Liberty Lobby, Inc, 477 U.S 242, 253, (186)

<sup>39</sup> El v. Septa, 479 F.3d, 232, 237, n.6 (3<sup>rd</sup> Cir.2007)

<sup>40</sup> Keller Brass Co. v Cont'l Brass Co., 862 F.2d 1063,1066 (4<sup>th</sup> Cir 1988)



barabartë.<sup>41</sup> Kur, megjithatë, gjetësi i faktit vjen në një përfundim përcaktues për ato të faktit, pas dëgjimit të të gjitha provave, nuk ka asnjë rast për të bllokuar barrën e bindjes.<sup>42</sup> Kjo barrë nuk ndikohet nga fakti nëse gjetësi i fakteve është një gjyqtar ose trup gjykues.<sup>43</sup>

Mejithatë, në shumicën e rasteve, kjo barrë vendoset tek pala që pretendon grindjen dhe kërkon të përfitojë nga ai.<sup>44</sup> Paditësi do të bartë barrën e bindjes për sa i përket pretendimeve të tij.<sup>45</sup> Ligji që rregullon adresimin e kërkesës apo mbrojtjes, megjithatë, mund ta rregullojë edhe barrën e bindjes,<sup>46</sup> dhe shpërndarja e saj në një veprim civil normalisht nuk do të ngrejë shqetësime kushtetuese.<sup>47</sup> Megjithëse, thuhet se, gjykata me iniciativën e vet dhe në rrethana të rralla mund të ndryshojë rregullin e përgjithshëm që pala që pretendon pretendimin apo mbrojtjen bartë edhe barrën e bindjes ndaj saj.<sup>48</sup> Disa gjykata, për shembull, shprehin nocionin se barra e provës lidhur me një ose më shumë çështje në një rast mund të vendoset për njërën palë për arsye të drejtësisë, por ato nuk përcaktojnë nëse barra e referuar është ajo e bindjes ose e prodhimit apo të dyja.<sup>49</sup>

## 5.2 Barra e prodhimit

Barra e prodhimit, e quajtur edhe barrë e vazhdimit, është detyrimi për të paraqitur prova të fakteve të nevojshme për të mbështetur një gjetje në mbështetje të një kërkesë ose mbrojtjeje.<sup>50</sup> Për të mbajtur barrën e prodhimit, një palë duhet të prezantojë prova të mjaftueshme për të bërë një kërkesë për ngritje të çështjes apo të mbrojtjes së vërtetë të faktit.<sup>51</sup> Barra e prodhimit është më e rëndësishme para gjyqit, sepse pala që e mban atë si një pretendim ose mbrojtje nuk mund të përballojë vendimin përmbledhës kundër tij pa e plotësuar atë barrë.<sup>52</sup>

---

<sup>41</sup>Schaffer, 546 U.S at 56. *Bristow v. Drake St. Inc.*, 41 F.3d 345, 353 (7<sup>th</sup> Cir. 1994) reh'g denied, 1995 U.S App. LEXIS 2063 (7<sup>th</sup> Cir 1995), *Lisbon Constructors*, 828 F.2d at 765.

<sup>42</sup> *Bristow*, 41 F.3d at 353.

<sup>43</sup> *Prickett v. United States*, 111 F.Supp. 2d 1191, 1192. (M.D. Ala. 2000) aff'd. 268 F.3d. 1066 (5<sup>th</sup> Cir 2001).

<sup>44</sup> Schaffer, 546 U.S at 58, *Martinelli v. Bridgeport Roman Catholic Diocesan Corp.*, 196 F.3d 409, 428. (2<sup>nd</sup> Cir 1999).

<sup>45</sup> Schaffer, 546 U.S at 56; *More v. Kulicke & Soffa Indus., Inc.*, 318 F.3d. 561, 566 (3<sup>rd</sup> Cir 2003).

<sup>46</sup> Schaffer. 546 U.S at 56.

<sup>47</sup> *Concrete Pipe and Prods.*, 508 U.S at 630; *United States v. Santoro*, 866 F. 2d 1538, 1544 (4<sup>th</sup> Cir 1989).

<sup>48</sup> Schaffer. 546 U.S at 56. *Alaska Dept of Env't Conversation*, 540 U.S at 494 n.17.

<sup>49</sup> *Martinelli*, 196 F.3d at 428; *United States v. 194 Quarker Farms Road*, 85 F.3d 985, 990 (2<sup>nd</sup> cir 1996), cert. denied sub nom, 519 U.S 932 (1996).

<sup>50</sup> *Moore*, 318 F.3d at 566; *Samuel*, 112 F.Supp.2d at 467.

<sup>51</sup> *In re North St. Access. Ltd. P'ship*, 184 B.R. 1, 7 (Bank. D. Mas. 1995)

<sup>52</sup> *El*, 479 F.3d at 237 n.6.

Në shumicën e rasteve, megjithatë, barra e prodhimit në mbështetje të një kërkesë ose mbrojtjeje fillimisht i është vënë palës së njëjtë që mban barrën e bindjes për atë pretendim ose mbrojtje.<sup>53</sup> Për shembull, sipas Rregullores Federale të Provave, një prezumim në vetvete në një çështje civile imponon barrën e prodhimit në palën kundër të cilës është thirrur prezumimi, por një prezumim i tillë nuk e zhvendos barrën e bindjes.<sup>54</sup>

Ndryshe nga barra e bindjes, e cila mbetet e fiksuar gjatë gjykimit, barra e prodhimit është barrë e zhvendosur.<sup>55</sup> Kur pala fillimisht e bartë barrën e prodhimit si dëshmi të fakteve të kërkesës apo mbrojtjes, pastaj, kjo barrë zhvendoset tek pala kundërshtare që të paraqesë dëshmi të mjaftueshme për të hedhur poshtë ato fakte të paraqitura ose për të krijuar një çështje materiale për gjetjen e faktorit.<sup>56</sup> Sidoqoftë, pala që mban barrën fillestare të ekspertizës, përballet me mbajtjen e barrës, kërkesës ose mbrojtjes se cila duhet të vendoset kundër tij, duke thënë se barra e bindjes mund të qëndrojë me palën tjetër.<sup>57</sup>

## 6. Zbatimi i barrës

Në fillim të një procesi gjyqësor civil, paditësi zakonisht bartë barrën e bindjes dhe të prodhimit sa i përket pretendimeve që pretendon për të paditurin.<sup>58</sup> Fokusi fillestar do të jetë në barrën e prodhimit dhe do të kërkojë që paditësi të paraqet prova të mjaftueshme të fakteve për të mbështetur një favor të tij nga fakti gjetës.<sup>59</sup> Nëse paditësi nuk arrin të përmbushë barrën e vet për të gjitha ose disa nga pretendimet e tij, këto kërkesa duhet të vendosen në atë rast.<sup>60</sup>

Kur paditësi e plotëson barrën, barra e prodhimit më pas do të zhvendoset tek i padituri. Për këtë, kur i padituri i ka mohuar ose i ka kundërshtuar faktet e paraqitura nga paditësi në mbështetje të kërkesës së tij, i padituri do të ketë barrën për të paraqitur prova për të hedhur poshtë ose të paktën të krijojë një çështje materiale në lidhje me ekzistencën e fakteve të tilla.<sup>61</sup> Përveç kësaj, i padituri duhet të plotësojë barrën e prodhimit për çdo mbrojtje afirmative të

---

<sup>53</sup> Moore, 318 F.d at 566; Simpson, 770 F.2d at 503; *Auburndale State Bank v. Dairy Farm Leasing Corp.*, 890 F.2d 888, 893 (7<sup>th</sup> Cir. 1989).

<sup>54</sup> FED.R.EVID.301; *McCann*, 458 F.3d at 287.

<sup>55</sup> *Bruner*, 996 F.2d at 293; *Samuels*, 112 F.Supp.2d at 467.

<sup>56</sup> *Bruner*, 996 F.2d at 293.

<sup>57</sup> 15 *Bosworth St.*, 236 F.3d at 55; *n re Anthem Cmtys.*, 267 B.R. at 871.

<sup>58</sup> Moore, 318 F.3d at 566.

<sup>59</sup> *Samuel*, 112 F.Supp.2d at 467.

<sup>60</sup> 15 *Bosworth St.*, 236 F.3d at 55; *In re Anthem Cmtys.*, 267 B.. at 871.

<sup>61</sup> 15 *Bosworth St.*, 236 F.3d at 55.

ngritur nga paraqitja e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij.<sup>62</sup> Dështimi i të paditurit për të përmbushur barrën e tij normalisht do t'i japë të drejtë paditësit që e ka përmbushur barrën e tij ndaj një vendimi të drejtuar. Nëse i padituri e përmbush barrën e tij, barra për të hedhur poshtë dëshminë do ta zhvendos barrën tek paditësi.

Vetëm kur gjyqtari i procedurës ka vendosur se të dyja palët kanë përmbushur ngarkesat e tyre përkatëse të prodhimit, atëherë gjyqtari duhet ti peshojë provat dhe të vendosë mbi numrin e të dhënave si dhe sipas standardeve të aplikueshme të provës nëse është plotësuar barra e bindjes për sa i përket pretendimeve dhe mbrojtjes.<sup>63</sup> Nëse gjyqtari kompetent përcakton që provat në mbështetje të një kërkesë ose mbrojtjeje të caktuar nuk i përmbushin standardet e kërkuara ose janë në mënyrë të barabartë, pala që mban barrën e bindjes për një pretendim apo mbrojtje të tillë duhet të humbasë.<sup>64</sup>

Barra e prodhimit kërkon që pala në lëvizje të bëjë një shfaqje *prima facie* të së drejtës së saj për gjykim përmbledhës. Mënyra e shfaqjes së saj varet nëse pala do të mbajë barrën e bindjes në gjykim. Nëse pala paditëse nuk do të mbajë barrën e bindjes në gjykim, i padituri mund të fitojë barrën e prodhimit ose duke paraqitur dëshmi që mohojnë një element thelbësor të pretendimit ose të mbrojtjes të paditësit ose duke demonstruar se provat e paqëndrueshme për atë pretendim ose mbrojtje është i pamjaftueshëm për të vendosur një element thelbësor të tij.<sup>65</sup>

---

<sup>62</sup> Nat'l Bus. Consultants, 376 F.3d at 322.

<sup>63</sup> Lisbon Contractors, 828 F.2d at 765; Samuel, 112 F. Supp.2d at 467.

<sup>64</sup> Schaffer, 546 U.S. at 56; Bristow, 41 F.3d at 353.

<sup>65</sup> Celotex Corp., 477 U.S. at 330-31 (dissemtomg op.).

## KAPITULLI II

### 2. Objekti i provës

Objekt i provës (*thema probandi*) janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike nga të cilat varet zbatimi i së drejtës materiale në procesin kontestimor. Objekti i provës nuk është çdo fakt që pretendohet nga palët, por vetëm ato fakte juridike që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Verifikimi i vërtetësisë së pretendimeve është i mundshëm vetëm në mënyrë të tërthortë duke u konstatuar ekzistimi i faktit i cili e përjashton mundësinë e ekzistimit të përnjëhershëm të faktit të kontestuar.<sup>66</sup>

Objekt i të provuarit mund të jenë edhe tezat e gjykatës për ekzistimin e fakteve, të cilat nuk janë paraqitur nga palët, kur duhen evituar disponimet e palejueshme të palëve.<sup>67</sup> Si argument se objekt i provës (i të provuarit) nuk janë drejtpërdrejtë faktet, por pretendimet për faktet, është se objekt i provës mund të jetë edhe pretendimi se një fakt i caktuar nuk ekziston. Ky është quajtur fakt negativ. Ky pretendim mohues negativ, mund të vërtetohet vetëm në mënyrë të tërthortë, me anë të konstatimit të qenies së faktit që e përjashton qenien e faktit të kundërshtuar. P.sh. i padituri në prapësimin e tij pretendon se shkresa e paraqitur nga paditësi është e falsifikuar, pasi nuk është shkrimi e nënshkrimi i tij. Ky pretendim negativ verifikohet me ekspertizë grafike. Po të rezultojë nga ekspertiza se pretendimi i të paditurit është i vërtetë, pra shkresa është e falsifikuar, do të thotë se është konstatuar qenia e një fakti (falsifikimi) që e përjashton qenien e faktit të kundërshtuar, rrëzohet pretendimi i paditësit për qenien e shkresës si fakt juridik.

Sipas së drejtës sonë civile të Republikës së Kosovës, me fakte juridike kuptohen ato rrethana që shkaktojnë lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve të marrëdhënieve juridiko civile. Rrethanat e tjera – faktet, me vërtetimin e të cilave ligji nuk lidhë pasoja juridike, nuk shkaktojnë pasoja juridike, d.m.th nuk krijojnë të drejta dhe detyrime juridike civile. Si rrjedhojë ato nuk ndikojnë aspak në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me vendim nga gjykata. P.sh. në mosmarrëveshjen që rrjedh nga kontrata e huasë si fakte juridike me rëndësi për objektin e të provuarit janë dhënia ose jo e një shumë të caktuar hua të paditurit, kthimi ose jo i huasë etj. Kur mohohet vetë kontrata e huasë me prapësimin që bën pala e paditur,

---

<sup>66</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.273

<sup>67</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 3 par . 3;

janë fakte juridike dhe si të tilla kanë rëndësi thelbësore ato fakte që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e njëres ose tjetres palë lidhur me lidhjen ose jo të kontratës. Fakt i rëndësishëm juridik mund të jetë një ngjarje e së kaluarës si veprimi ose mosveprimi që ka shkaktuar dëmin, moskthimi i të hollave të marra hua në afatin e caktuar etj.; mund të jetë gjendje që ka ekzistuar ose që vazhdon të ekzistojë si gjendje e një sendi etj. Nga këto fakte të rëndësishme, me të cilat ligji lidh edhe faktet juridike procedurale, objekt prove janë vetëm faktet kontestuese midis palëve. P.sh. njëra palë pretendon ekzistencën e një fakti, ndërsa pala tjetër e mohon ekzistencën e tij.<sup>68</sup>

## **2.1 Faktet kontestuese si objekt i të provuarit**

Faktet kontestuese janë faktet lidhur me ekzistimin e të cilave palët shprehin mendime të kundërta ku njëra palë pretendon se fakti i caktuar ekziston, kurse tjetra pretendon se ai nuk ekziston. Në këtë aspekt nuk ka nevojë të bëhet dallimi i rastit në të cilin kërkesa e palës bazohet në pretendimin se ekziston një fakt, nga rasti në të cilin kërkesa e saj bazohet në pretendimin se ai nuk ekziston (fakti negativ). Fakti negativ është kontestues dhe duhet të provohet, p.sh. kur paditësi kërkon që t'i kthehet shuma e të hollave e paguar pa bazë juridike, kurse i padituri pretendon se ajo ka ekzistuar.

Faktet të cilat midis palëve nuk janë kontestuese zakonisht nuk përbëjnë objekt prove dhe nuk kanë nevojë të provohen. Ekzistimi dhe përmbajtja e tyre zakonisht konstatohet me anë të veprimeve disponibile të palëve. Mirëpo, prapëseprapë gjykata është e autorizuar që t'i marrë edhe provat që nuk i kanë propozuar palët, po që se konstaton se ato tentojnë të disponojnë me kërkesat me të cilat nuk kanë të drejtë të disponojnë.<sup>69</sup> Në teori mbrohet mendimi se duhen provuar edhe faktet, të cilat pala kundërshtare as i ka mohuar e as i ka pranuar.<sup>70</sup>

## **3. Faktet që nuk kanë nevojë të provohen**

Me rregullat për nevojën e të provuarit jepet përgjigjja në pyetjen se cilat fakte provohen e cilat i merr gjykata pa i provuar fare për themel të vendimit të saj. Edhe pse e përbëjnë thelbin

---

<sup>68</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.274

<sup>69</sup> Po aty, neni 320

<sup>70</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.275

e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, nuk kanë nevojë të provohen, faktet e ditura botërisht, faktet e prezumuara nga ligji dhe faktet e pranuar (pohuara).<sup>71</sup>

### **3.1 Faktet e ditura botërisht**

Faktet të ditura botërisht (notore) nuk kanë nevojë të provohen e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëparshme.<sup>72</sup> Faktet e njohura botërisht nuk kanë nevojë të provohen, për shkak se ato njihen prej një rrethi të gjërë personash. Nga shkalla e rëndësisë së tyre varet edhe madhësia e rrethit të personave që janë të njohur me to. Kështu 17 shkurti 2008 si datë e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, njihet nga pjesa dërmuese e shqiptarëve në trojet amtare dhe në botë. Por ka fakte të tjera që njihen nga një rreth më i ngushtë personash, p.sh. njihet vetëm nga qytetarët e një qyteti ose rrethi, banorët e një fshati, si termeti, përmytje e madhe etj. Për t'u quajtur fakt i njohur botërisht kërkohet që të njihet si i tillë edhe nga gjykata. Ajo e çmon a është i njohur botërisht një fakt konkret e që si rrjedhojë nuk ka nevojë të provohet. Por, kjo nuk i mbron të drejtën palës kundër së cilës është fakti i njohur botërisht, të provojë se nuk e ka cilësinë e faktit të njohur botërisht.<sup>73</sup>

### **3.2 Faktet e prezumuara nga ligji**

Objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji i prezumon. Në vend të tij provohet baza e tij, në rast se kundërshtohet. Përveç prezumimeve ligjore kemi edhe prezumime të faktit ose të njeriut. Edhe ky lloj prezumimesh është pasojë që e nxjerr gjyqtari prej një fakti të ditur për të caktuar një fakt të paditur. Gjyqtari i cili e ka përvojën e caktuar në punë është në gjendje të nxjerrë faktin nga një prezumim duke u mbështetur në rrethana që hasen dhe vërtetohen zakonisht në jetë, kur një fakt zakonisht shoqërohet nga një tjetër ose është shkak apo pasojë e një tjetri. Në rastet e tilla, gjyqtari, nga përvoja e jetës dhe nga ajo që ka fituar gjatë gjykimeve, duke u mbështetur në arsyetimin logjik të gjërave, prej një ose disa fakteve që ekzistojnë, arrijnë në përfundimin e mundësisë së ekzistimit të një fakti tjetër për aq kohë sa që nuk provohet e kundërta. Andaj, prezumimet e faktit nxirren nga një veprim logjik, me anën e të

---

<sup>71</sup> Po aty, fq. 275

<sup>72</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 321 par . 1

<sup>73</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.276

cilit gjyqtari duke u mbështetur në disa fakte të njohura nxjerr një fakt të ri, që i shërben si mjet për formimin e bindjes deri në provimin e të kundërtës. Prezumimi, pra, nuk e ka rëndësinë e sigurisë. Merret se diçka që është e vërtetë, nga shkakut se prova e jetës na udhëzon që të bëjmë një gjë të tillë. Mirëpo, mund të ndodhë që në rastin konkret ngjarja të mos zhvillohet “normalisht, me fjalë të tjera që A-ja të mos i paraprijë B-së”, gjë që zakonisht ndodhë. Prandaj, edhe është paraparë mundësia e provimit se konkluzioni i përmbajtur në prezumim nuk i përgjigjet realitetit objektiv në situatën konkrete. Të provuarit e tillë quhet rrëzim i prezumimit me anë të provimit për të kundërtën.<sup>74</sup>

### 3.3 Faktet e pranuar (të pohuara)

Pranimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij. Faktet, të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor nuk ka nevojë të vërtetohen.<sup>75</sup> Pranimi i fakteve në kuptimin e plotë procedural e kemi vetëm kur pranohen faktet e disfavorshme, dhe kur ai bëhet gjatë zhvillimit të procesit kontestimor, para gjykatës së çështjes. Motivi i pranimit zakonisht është irelevant. Mirëpo, nëse gjykata bindet se pranimi i fakteve bëhet me qëllim të disponimit të palejueshëm, për të lindur detyra që vërtetësinë e tyre ta provojë me mjete provuese që i ka në disponim.<sup>76</sup> Pranimin e fakteve mund ta bëjnë të dy palët, secila nga to, faktet e pretenduara nga kundërshtari. Deklarata e pranimit të fakteve mund të jepet shprehimisht apo përfundimisht. Ajo e prodhon efektin e caktuar procedural posa të marrë në dijeni mbi të gjykata. Qëndrimi i palës tjetër mbi të nuk është relevant. Pranimi i fakteve mund të bëhet me shkrim apo gojarisht.

Deklaratën për pranimin e fakteve pala ka të drejtë që ta revokojë gjatë gjithë gjykimit. Në rast të revokimit, gjykata është e autorizuar që lirisht të çmojë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se a do të konsiderojë të pohuar apo të kundërshtuar faktin njëherë të pohuar, por më vonë të mohuar.<sup>77</sup> Kur pohimin e faktit e ka bërë përfaqësuesi i palës në seancën në të cilën ajo është e pranishme, deklaratën e tij ajo mund ta kundërshtojë aty për aty. Nëse pala nuk ka qenë e pranishme në seancën e tillë, ajo ka të drejtë që deklaratën e përfaqësuesit ta

---

<sup>74</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.277

<sup>75</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 32 par . 2

<sup>76</sup> Po aty, neni 3, par. 2

<sup>77</sup> Po aty, neni 321, par. 3

ndryshojë apo ta revokojë më vonë. Të njëjtën gjë pala mund ta bëjë edhe kur përfaqësuesi e ka bërë deklaratën e tillë me shkrim jashtë seancës. Këtë përfundim mund ta nxjerrim nga tërësia e dispozitave që vlejnë lidhur me pranimin e fakteve nga pala dhe përfaqësuesi i saj.

Kuptohet se pala mund ti pranojë më vonë faktet të cilat më parë i ka kundërshtuar. Poashtu, nga pohimi i fakteve duhet dalluar pohimin e kërkesëpadisë. Kur pala e bënë pohimin e fakteve, themi se ajo vërteton saktësinë e premisë minor në të cilën pala kundërshtare e mbështetë kërkesën e saj. E kur pala e pohon kërkesëpadinë, themi se ajo e vërteton themelësinë juridike të konkluzionit të cilin paditësi e nxjerr faktet e treguara në padi dhe e formulon në të duke marrur parasysh normën juridike të caktuar. Pohimin e kërkesëpadisë mund ta bëjë vetëm i padituri, kurse pohimin e fakteve mund ta bëjë edhe njëra edhe pala tjetër. Pohimi i kërkesëpadisë mund të bëhet vetëm me deklaratë shprehimisht të dhënë. Deklaratën me të cilën i padituri e pohon kërkesëpadinë, ai mund ta revokojë deri në momentin e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit. Në rast të revokimit të saj, aktgjykimi i përmendur nuk mund të jepet në asnjë rast, pa marrë parasysh se cilat rrethana konkrete kanë ndikuar në të paditurin që ta bëjë revokimin.<sup>78</sup>

#### **4. Natyra juridike e rregullave mbi marrjen e provës**

Në çështjet civile thuhet se barra ligjore e provës që mbështetet në njëren palë është në nivelin e balancës së probabiliteteve ose mbizotërimit të probabiliteteve.<sup>79</sup> Megjithatë, kjo deklaratë e thjeshtë fsheh një paqartësi të rëndësishme. A duhet që pala që bartë barrën e provës thjeshtë të tregojë se ka më shumë gjasa që të mos ekzistojnë kushtet e nevojshme për të vërtetuar rastin e saj apo të tij? Nga ana tjetër, a duhet gjetur faktori i faktit se ka më shumë gjasa se jo të ekzistojnë kushtet e nevojshme për të vërtetuar rastin e palës? Dallimi mund të jetë vendimtar. Supozoni se një paditës po përpiqet të tregojë se frenat e një veture të caktuar të një modeli ishin të dëmtuar. Nëse paditësi mund të konstatojë statistikisht se 51% e veturave të atij modeli kishin frenat e dëmtuara atëherë, në mungesë të provave të tjera, paditësi do të kishte treguar se kishte më shumë gjasa që frenat e ndonjë veture të veçantë të atij modeli të ishin të

---

<sup>78</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.277

<sup>79</sup> A different standard may, of course, be imposed by statute in civil cases, as with the Repatriation Act 1920 (Cth) which imposes the criminal standard on the Repatriation Commission. See *Repatriation Commission v Law* [1981] HCA 57; (1981) 36 ALR 411; *Repatriation Commission v Byrne* (1981) 40 ALR 296; *Repatriation Commission v Perrot* [1984] FCA 139; (1984) 53 ALR 690.



dëmtuar. E vërteta është se, kur ligji kërkon vërtetimin e ndonjë fakti, gjykata duhet të krijojë një bindje të vërtetë për ndodhjen ose ekzistencën e saj përpara se të gjendet e vërteta.

Standardi i zakonshëm i provës i kërkuar nga një palë që mban përgjegjësinë në procesin gjyqësor civil në këtë vend është prova për balancën e probabiliteteve. Nga ana tjetër, forca e provave të nevojshme për të vendosur një fakt apo fakte mbi balancën e probabiliteteve mund të ndryshojë sipas natyrës së asaj që kërkohet të provojë. Kështu që, deklaratat autoritative shpesh janë bërë për efektin që është e domosdoshme se provat e qarta ose bindëse kanë një çështje aq serioze sa të gjendet mashtrimi. Megjithatë, deklaratat për këtë qëllim nuk duhet të kuptohen si të drejtuara në standardin e provës.<sup>80</sup>

Më së shumti që mund të thuhet në mënyrë të vlefshme në një rast të tillë është se gjyqtari i gjykimit duhet të jetë i ndërgjegjshëm për peshën e pretendimeve të bëra në të dyja palët kur arrinë përfundimin e tij.<sup>81</sup>

Mund të kundërshtohet padrejtësia që i bëhet një paditësi, i cili mund të mohohet nga një vendim në favor të tij ose kur ai ka një shansë 51% ose më shumë që të ekzistojnë faktet e nevojshme për të vërtetuar pretendimin e paditësit. Një test i probabilitetit statistikor do të prodhonte vetë rezultate që do të dukeshin të padrejta. L Jonothan Cohen merr rastin e një rodeo në të cilin janë marrë një mijë vende, por vetëm 499 persona kanë paguar në rrotullim.<sup>82</sup> A duhet që pronari të jetë në gjendje të hedhë në gjyq 501 patronët e zgjedhur në mënyrë të rastësishme mbi bazën se në rastin e secilit person ka pasur 501 shanse në njëmijë që ai person nuk e kishte paguar? Është e saktë që ligji të kërkojë më shumë se një gjetje të probabilitetit në favor të personit që mban barrën e provës në çështjet civile dhe për këtë diçka të ndryshojë, duke marrë parasysh çështjen e veçantë të përfshirë.<sup>83</sup>

Murphy J hoqi implikimet nga rrënojat si tepër të lehta dhe bazoi vendimin e tij mbi teorinë e probabilitetit. Andaj, ai e arsyetoi se nga të tre mundësitë e dukshme - një shofer plotësisht për të fajësuar, shoferi tjetër jo plotësisht për të fajësuar dhe çdo shofer pjesërisht për

---

<sup>80</sup> Po aty 170

<sup>81</sup> Po aty 172.

<sup>82</sup> Cohen, *The Probable and the Provable*, above n89 at 75.

<sup>83</sup> This is not to suggest that considerations of probability should not form part of the process by which a court reasons to a conclusion. In *State Government Insurance Commission v Laube* (1984) 37 SASR 31 the court found that it had not been proved that the defendant had been so much under the influence of intoxicating liquor as to be incapable of exercising effective control of his vehicle. It is suggested that in reaching this conclusion the court gave insufficient weight to evidence that the majority of persons with the blood alcohol content the defendant was shown to have had would have been incapable of exercising effective control of a motor vehicle.

të fajësuar - dy qëndronin në favor të të paditurit, kështu që ajo duhet të ketë sukses në bilancin e probabiliteteve. Gjykatësi, megjithatë, nuk dha arsye adekuate për të hedhur poshtë një mundësi të katërt, një aksident i vërtetë, i cili ishte rezultat i asnjërit shofer. Kështu, një zbatim i duhur i arsyetimit të Murphy J krijon katër mundësi, vetëm dy prej të cilave favorizojnë rimëkëmbjen, me pasojë që i padituri duhet të ketë dështuar. Sidoqoftë, nuk është e ligjshme të përpiqesh të vendosësh rastet në bazë të teorive të përgjithshme rreth probabilitetit që nuk kanë lidhje me rrethanat e rastit të veçantë. Në realitet, arsyetimi i Murphy J ishte një përpjekje për të ndryshuar barrën e provës në veprimet e neglizhencës në Uellsin e Ri Jugor,<sup>84</sup> duke kërkuar që i padituri të paraqesë prova për të mposhtur argumentin e probabilitetit. Pamja e Murphy J u refuzua nga shumica e Gjykatës së Lartë. Andaj, shumica e dëshmitarëve deklaruan se nuk duhet të nxirren konkluzione lidhur me sjelljen e asnjërit prej shoferëve në mungesë të provave për të mbështetur konkluzione të tilla.

## 5. Qëllimi dhe rëndësia e marrjes së provës

Dëshmia është çelësi që një gjykatë duhet të marrë një vendim. Pa dëshmi nuk mund të ketë prova. Dëshmia i siguron gjykatës informata. Provimi i fakteve përmes paraqitjes së provave nënkupton bindjen e gjykatës për të pranuar një version të veçantë të ngjarjeve. Megjithatë, dëshmitë e marra përmes mjeteve të paligjshme nuk mund të kontribuojnë për ruajtjen e drejtësisë në të ardhmen. Rregulli i dëshmimeve civile, në lidhje me rregullat e procedurës, përcakton punën kornizë për procesin e provës dhe sjelljen e procesit gjyqësor.

Ligji i provave gjithashtu ka qëllim vendosjen dhe rregullimin e rregullave që kanë të bëjnë me procesin e provës në gjykata. Përderisa ky dimension është i rëndësishëm në procedimet civile. Edhe pse ekziston një konsensus mbi rëndësinë e ligjit të provave në formësimin e procesit të provës, ekziston një mosmarrëveshje në pyetjen nëse ligji i provave duhet të përcaktojë se cilat prova duhet të prodhohen dhe të cilat nuk janë, pra, në lidhje me relevancën. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë dy qasje. Sipas mendimtarëve të shquar ligjor si Jermi Bentham dhe William Twining, mbi të gjitha synojnë nëse procesi i gjyqimit është

---

<sup>84</sup> [1981] HCA 38; (1981) 148 CLR 62. See also *Andrews v John Fairfax and Sons Ltd* [1980] 2 NSWLR 255 at 262; *Girlock (Sales) Pty Ltd v Hurrell* [1982] HCA 15; (1982) 149 CLR 155; *Kilgannon v Sharpe Bros Pty Ltd* (1986) 4 NSWLR 600. Note Shane Simpson & Michael Orlov, 'An Application of Logic to the Law' [1980] UNSWLawJl 11; (1980) 3 UNSWLJ 415.

drejtësia e vendimmarrjes. Kjo arrihet me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale në faktet e vërteta në rastin e veçantë.

Sipas Bentham, shumica e rregullave të provave dhe procedurës çojnë në përjashtimin e shumë provave relevante, duke zvogëluar kërkimin e një të vërtetë të saktë dhe faktike. Andaj, duke njohur nevojën për disa kufizime, Bentham mendonte se ligji i provave ishte më se e nevojshme vetëm në masë të parandalimit të vonesave dhe të mos pengohet zhvillimi i procedurës dhe që të arrihet të zbulohet e vërteta e çështjeve duke përdorur taktika dhe qasje të ndryshme.

Megjithatë, përkrahësitë e qasjes së dytë argumentuan se padyshim do të ishte e padëshirueshme dhe kaotike nëse një gjyqtar kishte liri të pakufizuar për atë se cilat prova duhej të pranoheshin në një rast dhe si të tillë, ekziston qartë nevoja për të ekzistuar rregulla bazë për pranimin e provave në mënyrë që të zbatohen standardet e përbashkëta ndërmjet të gjitha gjykatave që merren me të njëjtin lloj të çështjeve. Prandaj, ata argumentuan se, për të dhënë drejtësi në kohën e duhur dhe efektive, roli i rregullave të provave që rregullon çështjen e relevancës është e padiskutueshme. Megjithatë kjo nuk do të thotë që gjyqtarët nuk kanë ndonjë liri veprimi. Në disa raste rregullat parashohin edhe përjashtime të detyrueshme të provave. Në raste të tjera, gjyqtarit i jepet diskrecioni për të përjashtuar provat relevante të cilat janë marrur në mënyrë të kundërligjshme, kur drejtësia e kërkon atë. Por nuk ka diskrecion gjyqësor për të përfshirë prova relevante, të cilat megjithatë, mund të kenë ndikim në kërkimin e së vërtetës, por që duhet të konsiderohen si të papranueshme duke zbatuar një rregullë të provave.

Koncepti i provës së lirë gjithashtu injoron rëndësinë themelore të të drejtave procedurale dhe rëndësinë simbolike të gjykimeve. Dhe drejtësia nuk duhet të bëhet vetëm, por duhet parë që të bëhet. Kjo është arsyeja pse shumica e gjykimeve mbahen në publik. Kjo do të thotë që publiku duhet të ketë besim në sistemin civil të saj të drejtësisë dhe në vendimet që jepen nga ai dhe kjo mund të ndodhë vetëm nëse gjykimi është perceptuar të jetë i drejtë. Andaj, respektimi i të drejtave procedurale nëpërmjet ligjit të dëshmive është një komponent kyç i së drejtës për një gjykim të drejtë.<sup>85</sup>

---

<sup>85</sup> <http://www.abysinnialaw.com/study-on-line/item/932-meaning-and-nature-of-evidence-law#>

## 6. Dispozitat ligjore për marrjen e provës

Ligji i Procedurës Kontestimore të Republikës së Kosovës nuk përmban rregulla të përgjithshme në lidhje me atë se si duhet ndarë barra e provës midis palëve. Në dispozita ligjore të natyrës materiale është dhënë përgjigjja e shprehur në këtë pyetje për disa situata kontestuese. Kështu p.sh. kush i shkakton dëme tjetrit duhet t'ia kompensojë atë në qoftë se nuk mund të provojë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij,<sup>86</sup> kujdestari, shkolla apo institucioni tjetër, nën mbikëqyrjen e të cilit ndodhet i mituri, përgjigjet për dëmin të cilin i mituri ia shkakton tjetrit, pos kur provon se mbikëqyrjen e ka bërë në mënyrën e paraparë me ligj dhe se dëmi do të shkaktohej edhe sikur mbikëqyrja të kryhej me kujdes të shtuar,<sup>87</sup> pronari i sendit mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi,<sup>88</sup> ai duhet ta provojë këtë të drejtë të tij, si dhe faktin se sendi ndodhet te i padituri etj.

Në praktikë jo kurdoherë është e lehtë të dallohet se cilës palë i bie barra e të provuarit të një fakti të caktuar, sidomos atëherë kur në dispozitat ligjore materiale nuk është e shprehur, si në shembujt e lartëcekura. Për të dalluar se cili nga ndërgjyqësit duhet të provojë një fakt, d.m.th. se cilit i bie barra e provës, ndihmon shumë ndarja e fakteve në fakte formuese, penguese dhe shuese. Fakte formuese ose konstitutive janë ato fakte që sjellin me vetë lindjen e një të drejte. P.sh. e drejta për të marrë çmimin nga shitja e një sendi, e drejta për të marrë pasurinë që rrjedh nga një trashëgim. Faktet formuese duhet të provohen nga pala që i pretendon, që zakonisht është paditësi. Faktet penguese janë ato fakte që pengojnë lindjen e një të drejte. P.sh. kryerja e veprimit juridik me mashtrim ose me kanosje, keqbesimi në posedimin e sendit. Zakonisht këto fakte pretendohen nga i padituri, por mund të pretendohen edhe nga paditësi. Prandaj, mund të themi se i takon barra e provës atij që i pretendon. Faktet shuese janë ato fakte që sjellin me vete shuarjen e një të drejte. P.sh. pagimi i çmimit për sendin e blerë, kthimi i huasë. Edhe këto fakte zakonisht i pretendon i padituri, prandaj i takon atij edhe barra e provës. Vështirësia kryesore qëndron në dallimin nëse fakti është formues apo pengues. Për të kapërcyer këtë vështirësi duhet të bëhet dallimi midis kushteve të nevojshme për qenien e marrëdhënie juridike, kur këto kushte janë specifike për një marrëdhënie juridike të caktuar, kemi të bëjmë me fakte formuese. P.sh. në kontratën e shitjes marrëveshja për çmimin dhe sendin, si dhe akti material kur sendi është i paluajtshëm; ose në kontratën e huasë marrëveshja për shumën e dhënë hua dhe afati i kthimit të

<sup>86</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës, neni 154

<sup>87</sup> Po aty, neni 167.

<sup>88</sup> Ligji nr. 03/L-154 për pronësi dhe të drejtat tjera sendore, neni 93

huasë, janë kushte specifike të shitjes e huasë dhe si të tilla përbëjnë fakte formuese. Disa kushte të tjera janë të përbashkëta për marrëdhënie juridike të ndryshme, si zotësia për të vepruar, vullneti i lirë për të kryer veprimin juridik etj, e kur këto mungojnë përbëjnë fakte penguese. Nga ky dallim i kushteve në marrëdhënien juridike, në kushte specifike dhe të përgjithshme del përfundimi tjetër se kushtet e përgjithshme të shumë marrëdhënieve juridike zakonisht ekzistojnë në të gjitha këto marrëdhënie (zotësia për të vepruar), është përjashtim, ndërsa kushtet specifike të një marrëdhënie juridike nuk janë në të gjitha marrëdhëniet juridike, kështu që qenia e tyre nuk është rregullë dhe si rrjedhojë mungesa e tyre (çmimi në kontratën e shitjes) nuk është përjashtim.<sup>89</sup>

Pikërisht në mbështetje të këtij dallimi të rregullit dhe të përjashtimit nga rregulli, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se duhet të provohen vetëm ato fakte që nuk janë rregull, d.m.th. vetëm ato që janë përjashtim, pra, duhet të provohen vetëm faktet specifike si fakte formues. Ndërsa faktet e përgjithshme ose të zakonshme, që përbëjnë rregullin, nuk duhet të provohen. Mungesa e një fakti ose kushti të përgjithshëm, si mungesa e zotësisë për të vepruar përbën përjashtim nga rregulli dhe pala që e pretendon një faktë të tillë që është pengues, duhet ta provojë. Duke u nisur nga ajo se barra e të provuarit të fakteve duhet të bazohet në dallimin midis asaj që është e rregulltë dhe asaj që përbën përjashtim nga rregulli, del përfundimi se mungesa e fakteve penguese është e përgjithshme dhe si e tillë përbën rregullin, ndërsa ekzistenca e fakteve penguese është përjashtim, prandaj, kur pretendohet qenja e kushtit ose faktit pengues nga i padituri, atij i bie barra e provës për qenjen e faktit pengues. Marrim si shembull kontratën e shitjes së një sendi të luajtshëm. Kur sendi i shitur është me të meta, blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi, ndër të tjerë, ndërrimin e sendit me të meta me një send pa të meta ose zbritjen e çmimit. Shitësi nga ana e tij pretendon se blerësi i dinte këto të metë në kohën e blerjes së sendit.<sup>90</sup> Si do të ndahet barra e të provuarit të pretendimeve. Duke u nisur nga dallimi i kushteve, faktet që përbëjnë rregullin nga kushtet për përjashtim, nxirret përfundimi se mungesa e të metave të sendit përbën rregullin, prandaj ato duhet t'i provojë blerësi që i pretendon si përjashtim.

Po ashtu pretendimi për dijeninë e të metave përbën përjashtim dhe këtë fakt duhet ta provojë shitësi që e pretendon, për arsye se si rregull i përgjithshëm blerësi nuk i di të metat e

---

<sup>89</sup> Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë, 2010, fq. 148

<sup>90</sup> Po aty, fq. 150

sendit. Ose në marrëdhëniet e trashëgimisë, trashëgimtari nuk është i detyruar të provojë zotësinë për të vepruar të trashëgimlënësit të tij që ka lënë testament apo zotësinë e vet për të trashëguar, por vetëm lidhjen e gjinisë dhe ekzistencën e testamentit. I takon palës tjetër që pretendon të provojë pazotësinë për të vepruar të trashëgimlënësit apo pazotësinë për të trashëguar të trashëgimtarit. Lidhur me faktet shuese, siç u tha më sipër barra e të provuarit si rregull i përket të paditurit. Ky duhet të provojë ekzekutimin e detyrimit që përbën fakte shuese. Por lidhur me ekzekutimin e detyrimeve duhet të bëhet dallimi midis detyrimeve pozitive e negative, d.m.th. midis detyrimeve për kryerjen e një veprimi dhe detyrimeve për mos kryerjen e një veprimi.

Në detyrimet për kryerjen e një veprimi paditësi duhet të provojë vetëm qënien e detyrimit, p.sh. duhet të provojë dorëzimin e sendit në huapërdorje të paditurit, por jo edhe moskthimin e tij nga ky i fundit. Ndërsa në detyrimet për mos kryerjen e një veprimi paditësi duhet të provojë qënien e detyrimit për të mos kryer veprimin, si dhe kryerjen e veprimit nga i padituri. Prezumimi ligjor që është analizuar në çështjen e mëparshme, ia lehtëson shumë barrën e të provuarit palës në dobi të sëcilës është ky prezumim. P.sh. pagimi i këstit të muajit të mëvonshëm të qirasë së energjisë elektrike prezumon pagimin e muajit të mëhershëm nga ana e përdoruesit.<sup>91</sup>

## 7. Barra e të provuarit dhe prezumimet ligjore

Prezumim (*praesumptio*) ligjor janë rregulla sipas të cilës gjykata është e detyruar që të marrë si ekzistuese një faktë (faktë i prezumuar) në qoftë se ekziston tjetri faktë i përcaktuar nga ligji (baza e prezumimit). Rëndësia dhe pasoja e prezumimeve qëndron në faktin se këta nuk kanë nevojë të provohen nga pala në dobi të të cilës janë.<sup>92</sup> Në vend se të provohen ato, pala e cila është e liruar që t'i provojë ata duhet ta provojnë bazën e prezumimit në qoftë se bëhet kontestuese ekzistimi i saj. Prezumimet ligjore, në teori, ndahen në të kundërshtueshme (prezumime relative – *praesumptiones juris tantum*) kur ligji e pranon vërtetësinë e fakteve derisa të provohet e kundërta dhe në të pakundërshtueshme (prezumime absolute – *praesumptiones juris et de jure*) kur ligji e ndalon kundërshtimin e vërtetësisë së fakteve, pra ndalon provimin e të kundërtës së tyre. Në sistemin tonë juridik prezumimet absolute janë të rralla, sepse nuk pajtohen me parimin e zbulimit të së vërtetës objektive.

<sup>91</sup> Po aty, fq. 151

<sup>92</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 321.

Prezumimet e kundërshtueshme të ligjit, janë një rregullë i vërtetë i provave dhe efekti i tij i vetëm është të zhvendoset barra e nxjerrjes së provave. Asgjë nuk mund të jetë më e thjeshtë, e administruar më lehtë, më efektive për të parandaluar konfuzionin dhe konfliktin. Megjithatë, nuk ka ndonjë klasë të rastit më të hutuar ose konfuzë, më të vështirë për të analizuar ose racionalizuar, sesa ato që merren me efektin e presupozimeve mbi barrën e provës. Praktika e vendosur në të paktën një juridiksion të rëndësishëm<sup>93</sup> e mohon teorinë e tyre. Dhe në çdo juridiksion ekzistojnë disa prezumime, jo thjeshtë supozime të faktit, shprehje të thjeshta të përvojës gjyqësore në lidhje me vlerën provuese të të dhënave të caktuara, e jo nga ana tjetër prezumimet përfundimtare të ligjit, por prezumime të vërteta të kundërshtueshme të ligjit në të cilat zbatohet e kundërta e teorisë. Prezumime ligjore të kundërshtueshme, të parashikuara janë kur debitorit i është kthyer dokumenti për borxhin, prezumohet se borxhi është shlyer<sup>94</sup>, në rastin, në të cilin kreditori ka dhënë një dëftesë për një sasi kamatash apo për një dhënie tjetër periodike, prezumohet se këstet nga e njëjta bazë juridike, të cilat janë bërë të kërkueshme më herët janë paguar.<sup>95</sup> Prandaj, debitori i cili mbrohet duke thënë se e ka paguar një këst, për të cilin është paditur, nuk ka detyrë të provojë faktin e tillë (faktin e prezumuar) në qoftë se i është dhënë dëftesa për ndonjë këst të mëvonshëm (*bazis*). Në rastin në të cilin paditësi mohon se ka dhënë dëftesë të tillë, atëherë i padituri duhet ta provojë faktin e tillë, gjë që nuk është e vështirë në qoftë se e ka në pronë dëftesën e tillë. Prezumimi ligjor, pra e kalon barrën e provës nga fakti i prezumuar në bazën e prezumimit dhe me të ia lehtëson të provuarit palës, të cilës i shkon në dobi prezumimi. Mirëpo, pala kundërshtare mund ta kontestojë vërtetësinë e faktit të prezumuar, përkundrajt përmbushjes së bazës së prezumuar. Për palën e tillë thuhet se e hedhë poshtë mundësinë e zbatimit të prezumimit ligjor me anë të provës për të kundërtën. Në rastin konkret, kreditori mund të provojë se kësti i mëhershëm nuk është paguar edhe pse për këstin e mëvonshëm ka dhënë dëftesë. Ndërsa, tjetra është se, për prezumimin ligjor është paraparë në ligjin për familjen i Kosovës, sipas të cilës, konsiderohet se fëmija është lindur në martesë në qoftë se është lindur gjatë martesës apo brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës.<sup>96</sup>

---

<sup>93</sup> Pennsylvania, where substantially every presumption recognized by the courts does shift the "risk of persuasion.

<sup>94</sup> Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 323

<sup>95</sup> Po aty, neni 312

<sup>96</sup> Ligji Nr. 2004/32, neni 99, par. 1.

Zbatimi i formulës që ka përpunuar për të përcaktuar se çfarë procesi është i duhur në një situatë të caktuar,<sup>97</sup> Në mënyrë të ngjashme, për shkak se interesi i prindërve në ruajtjen e kujdestarisë së fëmijëve të tyre është thelbësor, shteti nuk mund të ndërpresë të drejtat prindërore duke u mbështetur në një standard të mbizotërimit të provave - prova e nevojshme për të dhënë dëmshpërblime të parave duhet të provojë se prindërit janë të papërshtatshëm me dëshmi të qarta dhe bindëse.<sup>98</sup> Për më tepër, mosdiskriminimi i një prindi nuk mund të prezumohet thjeshtë për shkak të prezumimit të supozuar rreth karakteristikave të përgjithshme, por duhet të krijohet.<sup>99</sup> Përderisa prezumimi nuk është i paarsyeshëm dhe nuk është përfundimtar, ai nuk shkel klauzolën e procesit të rregullt ligjor. Në anën tjetër, nëse ekziston një lidhje racionale midis asaj që vërtetohet dhe çfarë rrjedh, legjislacioni që deklaron se prova e një fakti ose grupi faktesh përbën dëshmi prima facie të një fakti kryesor apo përfundimtar do të vazhdojë.<sup>100</sup>

Diskutime të mëdha u zhvilluan gjatë zbatimit të doktrinës pa hedhur poshtë prezumimin në rastet e përfitimeve. Kështu, ndonëse një shtet mund të kërkojë që jorezidentët të paguajnë pagesa të larta të shkollimit në kolegjet e shtetit se sa banorët dhe ndërsa gjykata prezumonte se një kërkesë për qëndrim të përhershëm do të lejohej si parakushtë për t'u kualifikuar për shkollim të ulët, u konsiderua e palejueshme për shtetin për të dyshuar përfundimisht se për shkak se adresa ligjore e një studenti ishte jashtë shtetit në kohën e aplikimit ose në një moment gjatë vitit të mëparshëm ai ishte një jorezidentë për atë kohë sa ai mbeti student. Klauzola e procesit të rregullt ligjor kërkoi që nxënësit t'u ofrohet mundësia të tregojë se ai është një banor me mirëbesim të drejtë për shkollim më të ulët.<sup>101</sup>

---

<sup>97</sup> Mathews v. Eldridge, 424 U.S. 319 (1976).

<sup>98</sup> Santosky v. Kramer, 455 U.S. 745 (1982). Four Justices dissented, arguing that considered as a whole the statutory scheme comported with due process. *Id.* at 770 (Justices Rehnquist, White, O'Connor, and Chief Justice Burger). Application of the traditional preponderance of the evidence standard is permissible in paternity actions. *Rivera v. Minnich*, 483 U.S. 574 (1987).

<sup>99</sup> *Stanley v. Illinois*, 405 U.S. 645 (1972) (presumption that unwed fathers are unfit parents). But see *Michael H. v. Gerald D.*, 491 U.S. 110 (1989) (statutory presumption of legitimacy accorded to a child born to a married woman living with her husband defeats the right of the child's biological father to establish paternity and visitation rights).

<sup>100</sup> Presumptions sustained include *Hawker v. New York*, 170 U.S. 189 (1898) (person convicted of felony unfit to practice medicine); *Hawes v. Georgia*, 258 U.S. 1 (1922) (person occupying property presumed to have knowledge of still found on property); *Bandini Co. v. Superior Court*, 284 U.S. 8 (1931) (release of natural gas into the air from well presumed wasteful); *Atlantic Coast Line R.R. v. Ford*, 287 U.S. 502 (1933) (rebuttable presumption of railroad negligence for accident at grade crossing). See also *Morrison v. California*, 291 U.S. 82 (1934).

<sup>101</sup> *Vlandis v. Kline*, 412 U.S. 441 (1973).



Doktrina në fakt i dha Gjykatës mundësinë për të zgjedhur midis përdorimit të klauzolës së mbrojtjes së barabartë ose klauzolës së procesit të rregullt në gjykimin e vlefshmërisë së klasifikimeve të caktuara.<sup>102</sup>

---

<sup>102</sup> Thus, on the some day Murry was decided, a similar food stamp qualification was struck down on equal protection grounds. *Department of Agriculture v. Moreno*, 413 U.S. 528 (1973).

## KAPITULLI III

### 3. Mjetet provuese

Mjete provuese (provë) quajmë çdo burim nga i cili me anë të organeve të shqisave nxjerrim njohuri për vërtetësinë e thënies se ekziston apo nuk ekziston një fakt për të cilin lidhet pasoja juridike e caktuar. Në ligj si mjete provuese janë parashikuar këqyrja e drejtpërdrejtë, dokumenti, dëshmitari, eksperti dhe palët. Sipas të drejtës sonë nuk është mjet provues pohimi i fakteve. Pohimi e ka rëndësinë e veprimit procedural me të cilin zakonisht përjashtohet nevoja e të provuarit. Mjete provuese janë edhe fotografitë, shiritat filmikë apo magnetoskopik etj., sepse mund të jenë objekt i këqyrjes së drejtpërdrejtë nga gjykata.

Parimisht gjykata është e autorizuar që pa kufizime të bëjë zgjidhjen e mjeteve provuese për t'i provuar faktet relevante. Në këtë procedurë nuk mund të merret prova me anë të dëgjimit të palëve. Ndërsa në anën tjetër, ligji vetëm për provimin e disa fakteve: marrëveshja për kompetencën tokësore,<sup>103</sup> autorizimi për përfaqësim<sup>104</sup>, ekzistimi i kërkesës në të holla në procedurën e dhënies së urdhërpagesës,<sup>105</sup> dhe ekzistimi i marrëveshjes së gjykatës së zgjedhur etj, e kërkon provën shkresore. Të gjitha mjetet provuese parimisht kanë fuqi provuese të njëjtë dhe të rëndësisë konkrete. Me ligj nuk është paraparë se në cilën rradhë merren provat. Përjashtim bënë të provuarit me anë të dëgjimit të palëve. Këtë mjetë provues gjykata e merr zakonisht kur nuk ka në dispozicion mjete të tjera, apo kur nga to nuk ka mundur të bindet për saktësinë e ndonjë pretendimi për faktin relevant.<sup>106</sup>

Andaj, duke pasur parasysh kriteret dhe veçoritë që ndiqen për ndarjen apo rindarjen e provave gjyqësore, edhe klasifikimi i tyre është i ndryshëm. Duke marrë parasysh burimin e përfitimit të provave, këto i ndajmë në prova personale, burimi i të cilave janë personat, palët, personat e tretë, ekspertët dhe dëshmitarët si dhe provat materiale burimi i të cilave janë sendet e botës materiale që ruajnë mbi vete gjurmë të një ndikimi të caktuar ose mund të jenë vetëm gjurmë të fakteve dhe ngjarjeve që janë relevante sikurse është p.sh., dokumenti, një gurë apo murë që këqyret nga ana e gjykatës. Ndërsa sipas mënyrës së formimit provat ndahen në dy grupe dhe ato janë, kryesore dhe të thjeshta. Kryesore janë ato që përfitohen nga burimi i parë si, bie fjala, thëniet e një dëshmitari që e ka parë ngjarjen me sytë e tij, një dokument origjinal,

<sup>103</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 66

<sup>104</sup> Po aty, neni 85

<sup>105</sup> Po aty, neni 493

<sup>106</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.280

këqyrja e një sendi që mban në vetëvete gjurmë të caktuara etj. Të thjeshta janë ato që përfitohen nga të tjerët, p.sh, thëniet e dëshmitarit, i cili nuk e ka parë ngjarjen vetë me sy, por e ka dëgjuar nga të tjerët, mandej njohuritë e marra nga kopja e një dokumenti etj. Më të rëndësishme janë provat kryesore, sepse kur marrja e dijenive ose të dhënat transmetohen nga njëri te tjetri shtohet mundësia e shtrembërimit të të dhënave për faktet, por kjo nuk do të thotë aspak që provat e thjeshta nuk përfillen në krahasim me të parat ose nuk duhet të shfrytëzohen nga gjykata, sepse si provat kryesore edhe ato të thjeshtat duhet verifikuar, nga gjykata për sa i përket vërtetësisë së tyre.

Sipas raportit ndërmjet provës dhe faktit konkret që përfitohet prej saj, provat ndahen në dy grupe. Kur prova është në lidhje të drejtpërdrejtë me faktin që rrjedh prej saj, quhet provë e drejtpërdrejtë, ose direkte. P.sh. thëniet e dëshmitarit se ka qenë i pranishëm kur paditësi i ka dhënë të paditurit dhjetë mijë Euro , janë provë e drejtpërdrejtë, sepse fakti juridik me rëndësi themelore për çështjen – numërimi e dhënia e dhjetë mijë Eurove, është përceptuar prej tij drejtpërdrejtë. Kur raporti ndërmjet faktit juridik e provës është jo i drejtpërdrejtë, por i tërthortë, quhet provë e tërthortë ose indirekte. P.sh. deklarimi i dëshmitarit se ka dijeni nga të tretët se paditësi i ka dhënë 10.000 Euro hua të paditurit. Në këtë rast dhënia e të hollave nga paditësi si fakt juridik nuk është përceptuar drejtpërdrejt nga dëshmitari, por nëpërmjet një prove ose rrethane tjetër.<sup>107</sup>

Prova e tërthortë si provë e veçuar (e vetme) nuk mund të çoj në përfundim të plotë e të bazuar. Kur nuk ka prova të drejtpërdrejta, është e nevojshme të kemi disa prova të tërthorta të lidhura midis tyre në atë mënyrë që të plotësojnë njëra tjetrën dhe si tërësi të japin faktin juridik të pretenduar. Shpesh këto provat e tërthorta mundësojnë për të arritur në përfundime të drejta e objektive, për të mbështetur një provë të drejtpërdrejtë ose për të hedhur poshtë ato, duke e përgenjështuar vërtetësinë e pretenduar të saj. Siç shihet provat e tërthorta përdoren qoftë si prova të pavarura për vërtetimin e fakteve, qoftë së bashku me provat e drejtpërdrejta, në mbështetje ose në kundërshtim të tyre. Provat e tërthorta marrin rëndësi sidomos kur gjykata nuk bindet ose dyshon për një provë të drejtpërdrejtë. Bie fjala dyshohet në vërtetësinë e një dëshmitari që është farefis me njërin palë. Këto lloj provash e ndihmojnë gjykatën jo vetëm në vlerësimin e provave të drejtpërdrejta, por formimin e një kuptimi të drejtë për mosmarrëveshjen e lindur dhe për përcaktimin e marrëdhënies juridike në kontest. Përdorimi i provave të tërthorta

---

<sup>107</sup> Po aty, fq. 281

është sa i vështirë aq dhe i nevojshëm për të arritur në përfundime të drejta e të plota për faktet.

Prandaj nuk duhet të nënvleftësohen asnjëherë provat e tërthorta. Pala që kërkon të bindë gjykatën se gjendja e faktit është e kundërt me ato që pretendon pala tjetër që e ka barrën e provës, paraqet kundërprova. Kundërprova merret sipas propozimit të palës e cila dëshiron që gjykata të bindet se gjendja faktike është e kundërt me atë që pretendon pala, të cilës i takon barra e të provuarit. Për t'u pranuar kundërprova mjafton që gjykata të mos ketë krijuar bindje të plotë në bazë të provave të paraqitura.<sup>108</sup>

### **3.1 Procedimi provues**

Me anë të rregullave për të provuarit parashihen veprimet të cilat duhet kryer në formën e paraparë me qëllim që të arrihet rezultati i të provuarit. Të provuarit e përbëjnë këto aktivitete të palëve dhe gjykatës, palët i ofrojnë provat, gjykata e vlerëson çdo ofrim të tillë dhe me aktvendimin për të provuarit provat i lejon ose i refuzon, provat merren me pjesëmarrjen e palëve, për marrjen e provave përpilohet procesverbali dhe në fund bëhet shoshitja dhe çmuarja e provave. Gjykata nuk është e detyruar të pranojë çdo provë të paraqitur nga palët, por vetëm ato prova që janë të nevojshme për të provuar faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes civile. Për këtë qëllim gjykata cakton me vendim rrethin e fakteve që duhet të provohen, provat që janë të nevojshme për vërtetimin e tyre, si dhe mënyrën e kohën e marrjes së tyre. Po ashtu me vendim ajo refuzon marrjen e atyre provave të paraqitura nga palët që nuk kanë rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky quhet vendim i ndërmjetëm i gjykatës.

Vendimi duhet të përmbajë: lejohet ose jo marrja e provës së kërkuar nga cila palë ndërgjyqëse është paraqitur, cilat fakte do të provohen me këtë provë dhe si e ku do të merret prova. Lidhur me lejimin e provës duhen patur kurdoherë parasysh edhe kërkesat e normave materiale në lidhje me mjetet e lejueshme provuese për marrëdhënie të ndryshme juridike. Kështu p.sh. veprimet juridike që duhen bërë me shkresë nuk mund të provohen me dëshmitarë; kontrata e qirasë mbi një vit. Në raste të tilla gjykata nuk do të pranojë dëshmitarët si mjet provues, duke u shprehur për këtë me vendim. Si rregull provat merren në seancë gjyqësore dhe nga i njëjti trup gjykues. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon një nga anëtarët e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç kur ai kërkon që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues, provat

---

<sup>108</sup> Po aty, fq. 282

merren në shqyrtim nga fillimi. Kur për një fakt nga provat janë marrë të dhëna të mjaftueshme, gjykata me vendim mund të rrefuzojë marrjen e provave të tjera për atë fakt. Duke u nisur nga parimi procedural se gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, ajo gjatë gjykimit duhet të njihet drejtpërdrejt me provat, të dëgjojë vetë dëshmitarët e ekspertët, të shqyrtoj dokumentet e të kqyrë sendet që shërbejnë si provë. Vetëm përjashtimisht, kur prova nuk mund të merret në seancë gjyqësore, p.sh. dëshmitari është i sëmurë, ose banon në një rreth gjyqësor tjetër. Në rastin e parë pyetja e dëshmitarit bëhet jashtë qendrës së gjykatës nga një anëtar i gjykatës që vendos gjykata. Në rastin e dytë, gjykata i delegon kompetencat e saj gjykatës së vendit ku ndodhet prova, ose me kërkesën e të dy palëve delegohet njëri prej anëtarëve të trupit gjykues. Në vendimin e ndërmjetëm caktohet edhe afati i marrjes së provës si dhe data e seancës për vazhdimin e gjykimit. Veprimet e kryera nga gjyqtari për marrjen e provës pasqyrohen në procesverbal, i cili lexohet në seancë. Palët kanë të drejtë të marrin pjesë në marrjen e provës, p.sh. në pyetjen e dëshmitarit, kqyrjen në vend, kqyrjen e dokumenteve etj.<sup>109</sup>

### **3.2 Koha e paraqitjes së provave**

Koha e paraqitjes së provave nga palët është me rëndësi parësore për sigurimin e një procedimi provues të rregullt dhe evitimin e zvarritjes së gjykimit. Prandaj është parashikuar rregulli se provat duhet të tregohen në kërkesë padi. Padiësi duhet të tregojë provat ku i mbështet kërkimet e tij. Po ashtu edhe i padituri me marrjen e kërkesë padisë, nëpërmjet përgjegjes ndaj padisë, duhet të paraqesë provat ku mbështeten prapësimet e tij. Por, kjo nuk ua heqë të drejtën palëve për të paraqitur prova të tjera, dhe gjykata, kur vëren se është në dobi të procesit gjyqësor, lejon marrjen e tyre. Po ashtu palët kanë të drejtë të kërkojnë edhe riçeljen e procesit gjyqësor për të paraqitur prova të reja, të paparaqitura deri atëherë, d.m.th. deri në përfundim të hetimit gjyqësor. Për riçeljen ose jo të hetimit gjyqësor vendos gjykata, sipas vlerësimit të rrethanave të çështjes. Në praktikën gjyqësore mund të ndodhë që palët, për shkaqe të pavarura prej tyre ose për shkak të pengesave të ndryshme, e kanë patur të pamundur ose tepër të vështirë të sigurojnë një ose disa prova gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë. Në raste të tilla ato kanë të drejtë të paraqesin prova të reja. Ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm

---

<sup>109</sup> <http://forpeopleforjustice.com/standards-of-proof-in-civil-cases/>

procedural. Gjykata e Apelit në shkallë të dytë ka të drejtë të marrë çdo lloj prova të parashikuara p.sh. në një rast Gjykata e Apelit ka gabuar ligjërisht dhe ka bërë shkelje procedurale kur nuk është shprehur fare lidhur me një akt ekspertimi grafik, të paraqitur nga pala paditëse në shkallë të dytë si një provë të re, meqenëse nuk ka mundur ta sigurojë gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë. Me këtë provë të re pala paditëse (ose e paditur) i mbështet pretendimet e saj lidhur me vendimin e shkallës së parë, prandaj gjykata e shkallës së dytë duhet të shprehet patjetër për marrjen ose jo të saj, por kurrësi nuk ka të drejtë të mbajë qëndrim të heshtur lidhur me provën e re.<sup>110</sup>

### 3.3 Marrja e provave

Gjykata ka për detyrë të caktojë mënyrën, kohën dhe vendin e marrjes së provave. Provat rregulisht merren në seancën për shqyrtimin kryesor nga i njëjti gjyqtar. E gjithë kjo varet nga specifikat e objektit të të provuarit dhe të mjetit provues. Marrja e provave është veprim procedural i gjykatës me anën e të cilit ajo merr dijeni për bazat e të provuarit nga mjetet provuese. Ajo ka detyrë që palëve t'ua mundësojë leximin e dokumenteve, shikimin e objektit të këqyrjes, pyetjen e dëshmitarëve, ekspertëve etj. Palët gjithashtu, kanë të drejtë që të shfaqin mendimin lidhur me rezultatin e të provuarit. Shfrytëzimi i informatave nga mjetet provuese është, në rend të parë detyrë e gjyqtarit të çështjes. Një gjë të tillë ai e bënë sipas krijimit të bindjes dhe vlerësimit të çmuarjes së lirë të provave etj. Gjyqtari është ai që e cakton rradhën për shfrytëzimin e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve. Gjykata mund të heq dorë nga marrja e provës së caktuar me anë të vendimit në qoftë se, nga provat tjera merr dijeni të mjaftueshme lidhur me objektin e të provuarit. Prova e cila është marrë nga gjyqtari i gjykatës së porositur, apo nga vetë gjyqtari shfrytëzohet gjatë zhvillimit të procedurës në seancën për shqyrtimin kryesor, duke e lexuar procesverbalin e përpiluar me atë rast. Kjo rregull vlen edhe në rast të sigurimit të provës (paraprova).<sup>111</sup>

Gjatë shqyrtimit kryesor për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari mund të vendos që provat të merren në seancë të posaçme. Kjo seancë mbahet para gjyqtarit dhe në të nuk kryhet asnjë punë tjetër, por vetëm merret prova, ose disa sosh, e caktuar me vendim të gjykatës. Si shkak i arsyeshëm për marrjen e provës në këtë mënyrë mund të jetë, p.sh., nevoja që dëshmitari i

<sup>110</sup> Definition of Burden of Proof, page 12, September 26, 2010, <http://www.yourdictionary.com/burden-of-proof>.

<sup>111</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.284

sëmure të pyetet në banesën e tij apo në spital, apo nevoja që prova të merret me anë të kqyrjes së një objekti jashtë gjykatës për shkak të papërshtatshmërisë që të silllet në sallën e gjykimit. Kur paraqitja e dokumenteve në gjykatë është e vështirë për shkak se ato mund të jenë të shumta, voluminoze, ose për ndonjë shkak tjetër, gjykata ka të drejtë të kërkojë pjesët e nxjerra prej tyre që i interesojnë shqyrtimit të çështjes, ose mund të urdhërojë që të bëhet një kqyrje e dokumenteve në vendin ku ato ndodhin.

Si shkak i arsyeshëm për marrjen e provës jashtë seancës për shqyrtimin kryesor duhet konsideruar edhe atë që, flet për nevojën e marrjes së provës në rrugë të ndihmës juridike. Në rast të tillë seanca për marrjen e provës mbahet para gjyqtarit të gjykatës së porositur. Kështu veprohet, p.sh., kur disa nga provat gjenden jashtë rrethit ku e ka qendrën gjykata e çështjes. Për marrjen e tyre ngarkohet gjyqtari i gjykatës së vendit ku këto ndodhen. Ky veprim kryhet me anë të letërporosisë. Në letërporosi duhet të tregohen palët midis të cilave gjykohet çështja, objekti i kontestit, lloji i provës që duhet të merret (të pyetët dëshmitari, të kqyret sendi, etj), çfarë kërkohet të sqarohet nëpërmjet saj, afati brenda të cilit duhet të merret prova dhe eventualisht dita që është caktuar për shqyrtimin e çështjes. Pas plotësimit të letërporosisë, procesverbali që mbahet rreth saj, i nënshkruar nga gjyqtari dhe procesmbajtësi i kthehet gjykatës që e ka dërguar letërporosinë. Në seancën e posaçme për marrjen e provës palët nuk thirren vetëm në qoftëse kanë deklaruar, në gjykatën e çështjes, se nuk dëshirojnë të marrin pjesë në të. Mosparaqitja e tyre në seancë, përkundrajt faktit që janë thirrur rregullisht, nuk e shkakton pezullimin e gjykimit. Në rast të tillë, seanca mbahet në mungesën e të dy palëve. Në seancën në fjalë, gjyqtari i gjykatës së porositur, kur mendon se ka nevojë mund të merr edhe prova të reja, të cilat nuk janë caktuar me aktvendimin e gjykatës.

Shoshitjen e rezultatit të provave e bëjnë palët në fjalët e tyre të fundit. Ato deklarohen lidhur me besueshmërinë e provave të shfrytëzuara dhe fuqinë provuese të tyre, dmth., e bëjnë çmuarjen e provave. Çdo njëra nga to e jep mendimin se, a ka pasur sukses apo jo prova e shfrytëzuar, a është vërtetuar apo jo vërtetësia e faktit që ka qenë objekt i të provuarit, duke e mbështetur atë, në arsye që dalin nga analizat e bëra të bazave provuese.<sup>112</sup>Nëse provat janë marrë nga gjyqtari apo gjyqtari i gjykatës së porositur, në gjykatën e çështjes caktohet seanca për shoshitjen e provave të shfrytëzuara, përveç kur palët kanë hequr dorë nga një gjë e tillë, përkatësisht kur gjykata e quan të tepër shqyrtimin e provave të shfrytëzuara nga to. Pra, gjykata

---

<sup>112</sup> Po aty, fq. 285

mund të vendos që provat e caktuara të merren përpara një gjykate tjetër (gjykata e porositur). Në rast të tillë, procesverbali mbi provën e marrë lexohet në seancë për shqyrtimin kryesor të çështjes.<sup>113</sup>

### **3.4 Çmuarja (vleresimi) i provave**

Çmuarja e provave është një veprim i gjykatës që shqyrton një mosmarrëveshje juridike civile, me anë të cilit ajo, pas përfundimit të hetimit gjyqësor, vlerëson fuqinë provuese të provave të paraqitura dhe arsyeton qëndrimin e vet si dhe përse i ka vlerësuar ato prova në çështjen konkrete. Me fjalë të tjera çmuarja e provave është konkluzioni i gjykatës sa, si dhe përse provat e paraqitura (ose administruara) vërtetojnë ekzistencën ose mos ekzistencën e fakteve dhe rrethanave që kanë rëndësi dhe ndikim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Çështjen e ndërlikuar dhe jo rrallë mjaft të vështirë se cilat fakte do të quhen të provuara, do ta zgjidhë gjykata sipas bindjes së vet, më bazë çmuarjes së ndërgjegjshme e me kujdes të çdo provë në veçanti dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në bazë të rezultatit të të gjithë procesit gjyqësor. Pikërisht këtu qëndron edhe thelbi i teorisë së çmuarjes së lirë të provave (teoria e bindjes së lirë të gjyqtarit). Sipas kësaj teorie një fakt është i provuar vetëm po të ketë krijuar bindje gjykata se ai ekziston dhe e kundërta: fakti nuk është i provuar kur gjykata dyshon për ekzistencën e tij.

Çmuarja që bën gjykata, sipas kësaj teorie, është shumë konkrete. Lloji dhe numri i mjeteve provuese që janë përdorur nuk janë vendimtare në këtë çmuarje. Teoria e çmuarjes së lirë të provave përbën një tërësi me parimin e së vërtetës materiale. Qëndrimi i gjykatës lidhur me të provuarit e fakteve, formohet gradualisht, me çmuarjen pas çdo prove të paraqitur. Mirëpo qëndrimin përfundimtar për këtë çështje gjykata e mban vetëm pasi të merren të gjitha provat. Garancia për mosshpërdorimin e lirisë së çmuarjes nga ana e gjykatës qëndron në detyrën e saj që çmuarjen e provave ta arsyetojë në vendim. Prandaj vendimi i gjykatës shpesh konsiderohet shprehje e aftësisë profesionale dhe ndershmërisë së gjyqtarit. Teoria e çmuarjes së lirë të provave nuk shtrihet mbi çdo lloj prove. Kështu, kur bëhet kqyrja e një objekti, p.sh. kqyrja e një banese për të përcaktuar prej sa ndarjeve e kateve përbëhet, nuk ka vend për çmuarje të provave

---

<sup>113</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 324, par. 2



lidhur me faktin real të konstatuar nga kqyrja. Po ashtu nuk bëhet nga gjykata çmuarja e fuqisë provuese të një dokumenti zyrtar.<sup>114</sup>

### **3.5 Sigurimi i provës (paraprovës)**

Në situatën kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e kontestit ose që ndikon në sqarimin e tij, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar mund të urdhërohet marrja para kohe e saj, qoftë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor qoftë para fillimit të tij. Kërkesa për sigurimin e provës mund të bëhet para dhe gjatë procedurës së iniciuar për përsëritjen e gjykimit të përfunduar me vendim të formës së prerë por gjithsesi po që se plotësohen kushtet e mësipërme. Kompetente për sigurimin e provës është gjykata që është duke shqyrtuar çështjen e në rast se padia nuk është ngritur ende, gjykata e vendit ku ka banim personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret. Në rastet e ngutshme kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet në gjykatën e vendit ku ka banim personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret, përkundrejt faktit se padia është ngritur. Në kërkesën për sigurimin e provës duhet të tregohen prova që do të merret, rrethanat dhe faktet për vërtetimin e të cilave shërben ajo dhe arsyet që e justifikojnë marrjen e saj përpara se të vijë koha normale për marrjen e provave. Në kërkesë duhet të tregohet emri dhe mbiemri i palës kundërshtare, përveç kur ajo është e panjohur. Kopja e kërkesës i komunikohet palës kundërshtare, përveç kur ajo nuk dihet ose kur marrja e provës nuk lejon shtytje. Në qoftë se palës kundërshtare nuk i është dërguar me parë kërkesa për sigurimin e provës, atëherë ajo i dërgohet bashkë me aktvendimin me të cilin është pranuar dhe caktuar seanca për marrjen e provës. Palës kundërshtare të panjohur, apo të cilës nuk i dihet vendbanimi, gjykata mund t'ia emëroj përfaqësuesin e përkohshëm me qëllim që të marrë pjesë në seancën e caktuar për marrjen e provës. Për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm nuk ka nevojë të bëhet shpallje publike.

Në rastet e ngutshme gjykata mund të vendosë që prova të merret para se t'i dërgohet vendimi, me të cilin është pranuar kërkesa për sigurimin e provës, palës kundërshtare. Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin pranohet propozimi për sigurimin e provës, si dhe kundër

---

<sup>114</sup> <https://www.bc-llp.com/what-is-the-burden-of-proof-in-a-civil-case/>

aktvendimit me të cilin vendoset që marrja e provës të filloj para se aktvendimi t'i dërgohet palës kundërshtare, nuk lejohet ankimi. Mosparaqitja e palës që ka kërkuar sigurimin e provës në seancën për marrjen e provës sjell refuzimin e propozimit, përveç kur marrjen e saj e kërkon pala kundërshtare ose kur gjykata çmon se kjo është në dobi të procesit gjyqësor.

## KAPITULLI IV

### 4. Mjetet provuese veç e veç

#### 4.1 Këqyrja drejtëpdrejt

Këqyrja në vend ndërmerret sa herë që çmohet e nevojshme që për vërtetimin e ndonjë fakti, apo për sqarimin e ndonjë rrethane, duhet të bëhet vrojtimi i drejtëpdrejt nga gjykata e çështjes. Ky mjet provues shërben për të vënë gjyqtarin në mundësi që të marrë dijëni për gjendjen dhe cilësitë e personave dhe sendeve. Marrja e provës me anë të këqyrjes së drejtëpdrejtë mund të bëhet edhe me bashkëveprimin e ekspertit. Po që se sendi që duhet këqyrë nuk mund të sjellët në gjykatë apo në qoftë se sjellja e tij do të shkaktonte shpenzime të mëdha, gjykata e bënë këqyrjen e sendit në vendin ku ai ndodhet dhe me atë rast hartohet procesverbali.

#### 4.2 Koha dhe vendi i këqyrjes se drejtëpdrejt

Këqyrja e personave dhe e sendeve si dhe këqyrja në vend janë quajtur këqyrja e drejtëpdrejtë. Si një nga mjetet provuese këqyrja e drejtëpdrejtë i jep mundësi gjykatës të marrë dijëni vetë pa ndërmjetësimin e të tjerëve për gjendjen dhe veçoritë kryesore të personave dhe sendeve të luajtshme e të paluajtshme. Ky mjet provues i shërben gjykatës për të verifikuar vërtetësinë e thënieve të dëshmitarëve, të pretendimeve të palëve, madje disa herë edhe konkluzionet e ekspertëve, duke përfituar kështu edhe një provë të re.

Me këqyrjen e personave, këqyrjen e sendeve dhe këqyrjen në vend si veprim procedural, krahas verifikimit të fakteve të kontestueshme mund të zbulohen edhe qenia e fakteve të tjera të rëndësishme. Këqyrja mund të vendoset si me kërkesën e palëve ashtu edhe kryesisht nga gjykata.<sup>115</sup> Në vendimin e gjykatës për këqyrjen caktohet vendi, koha dhe mënyra e këqyrjes (nga i gjithë trupi gjykues apo nga një gjyqtar i deleguar). Kur shihet e nevojshme në këqyrje mund të marrë pjesë edhe një ekspert teknik, i cili vepron sipas dispozitave për ekspertimin.<sup>116</sup> Këqyrja bëhet kurdoherë pas njoftimit të palëve për të marrë pjesë në këqyrje. Duhet patur kujdes që gjatë këqyrjes së personit të mos preket dinjiteti i tij personal. Kur lind një dyshim i tillë ajo mund të mos marrë pjesë në këqyrje, duke u mjaftuar në dërgimin e një eksperti.<sup>117</sup> Për këqyrjen e kryer mbahet procesverbal i posaçëm, ku shënohen personat që kanë marrë pjesë, objekti e rrethanat e

<sup>115</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 286

<sup>116</sup> Po aty, neni 287

<sup>117</sup> Po aty, neni 288

kqyrjes si dhe vërejtjet e pjesëmarrësve. Në fund procesverbali nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Ky procesverbal administrohet në seancë gjyqësore. Kemi përshtypjen se kqyrja nuk shfrytëzohet sa duhet nga gjykatat, as atëherë kur është më se e nevojshme. Kqyrja si mjet provues, me gjithë që me të provohet vetëm gjendja e tanishme e fakteve, ka epërsi sepse mundësia e gabimit është minimal.

### **4.3 Provat shkresore (dokumentet)**

Dokumentet ose provat shkresore që parashikohen si një nga llojet e mjeteve provuese janë mjete me anë të të cilave nëpërmjet shenjave shprehen mendime që përmbajnë të dhëna për faktet, të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e një kontesti. Shprehja e mendimeve mund të bëhet për letër, dru, metal etj., kurse shenjat e shkrimit mund të jenë shkronja, shifra, shenja telegrafike, stenografike, tipografike, etj. Objekti për të cilin mund të shprehen mendimet nuk është provë shkresore në qoftë se në të mungon shprehja e mendimeve me anën e shenjave. Prandaj, nuk konsiderohen se janë dokumente në kuptimin e procedurës civile shenjat kufitare, skicat, planet etj. Dokumenti me shkrim i cili i ka cilësitë e përmendura përbën mjet provues, pa marrë parasysh se a është hartuar me qëllim të të provuarit. Prova me shkresë zë një vend me shumë rëndësi në gjykimin civil dhe gjykatat ndeshen shpesh me problemet që lindin nga ky mjet provues. Rëndësia e dokumentit rritet ditë e përditë, sepse subjektet e së drejtës përditë e më shumë i japin deklaratat e tyre në formë të shkruar, e deklaratat e dhëna gojarisht i vërtetojnë me shkrim.<sup>118</sup> Sipas legjislacionit tonë nuk është paraparë kurrfarë kufizimi në pikëpamje të përdorimit të dokumenteve me qëllim të provimit të fakteve relevante. Ligji vetëm në disa raste kërkon që faktet e caktuara të provohen vetëm me anë të provave shkresore. I tillë është rasti me marrëveshjen për prorogacionin<sup>119</sup>, me marrëveshjen për gjykatën e zgjedhur<sup>120</sup> dhe me kredinë për të cilën kërkohet dhënia e urdhërpagesës së dokumentuar.<sup>121</sup> Në pikëpamje të objekteve të tjera të cilat shërbejnë si mjet provues për ekzistencën e ndonjë fakti relevant vlejnjë rregullat për këqyrjen e drejtëpërdrejtë.

---

<sup>118</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.291

<sup>119</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 66

<sup>120</sup> Po aty, nenet 511-531

<sup>121</sup> Po aty, nenet 492 - 504

#### **4.4 Llojet e dokumenteve provuese**

Sipas kriterëve të ndryshme që përdoren për ndarjen e provave shkresore, ato i dallojmë në dokumente publike dhe jopublike (private), në dokumente për provueshmëri dhe për vlefshmëri, në dokumente dispozitive dhe informative, në dokumente të vendit dhe të huaja, në dokumente origjinale dhe kopje etj.

Dokumentet publike janë të gjitha ato shkresa të cilat i ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.<sup>122</sup> Për të qenë dokumenti publik, pra, duhet të plotësohen tri kushte: të jetë lëshuar nga organi kompetent, të jetë lëshuar në formën e paraparë dhe të jetë lëshuar brenda kufijve të kompetencës së organit kompetent.

#### **4.5 Fuqia provuese e dokumenteve**

Shkresat janë objekt material në të cilin me anë të shenjave të shkruara është shprehur një mendim. Duke marrë parasysh hartuesin, ligji i dallon shkresat publike dhe shkresat tjera. Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike. Lejohet që të provohet se në shkresën publike faktet janë konstatuar jo saktësisht apo se shkresa është hartuar në mënyrë jo të rregullt. Po që se gjykata dyshon në autenticitetin e shkresës, mund të kërkojë që për këtë të deklarohet organi nga i cili shkresa duhet të jetë hartuar. Po që se me kontratë ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, shkresat publike të huaja të legalizuara sipas ligjit, kanë, me kusht reciprociteti, të njëjtën fuqi provuese sikurse shkresa publike e vendit.<sup>123</sup>

---

<sup>122</sup> Po aty, neni 329, par. 1.

<sup>123</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.293

## 4.6 Paraqitja dhe kërkimi i dokumenteve

Legjislacioni i Republikës së Kosovës parasheh edhe mënyrën e paraqitjes dhe kërkimit të dokumenteve nga neni 331 deri 333 të LPK-së. Sipas këtyre dispozitave dokumentet që janë në gjuhë të huaj duhet të paraqiten në gjykatë bashkë me përkthimin e tyre të verifikuar.<sup>124</sup> Rregullisht dokumentet paraqiten nga palët, por edhe vetë gjykata, në përputhje me parimin e rolit aktiv në gjykimin e çështjes, ka të drejtë që kryesisht ose me kërkesën e palës t'i kërkojë nga organet shtetërore ose personat juridikë të cilëve u është besuar kryerja e funksionit publik, ku ndodhen ato. Gjykata vepron kështu sidomos kur pala nuk mundet vetë t'i marrë ato nga subjektet e përmendura.<sup>125</sup> Me qëllim të marrjes së dokumentit gjykata mund t'i japë palës së interesuar një shkresë me anën e së cilës ajo legjimitohet te subjekti ku ndodhet dokumenti.

Kur dokumenti ka rëndësi për të provuar pretendimet e palës te e cila ndodhet ai, atëherë ajo është e detyruar ta paraqesë vetë atë në gjykatë. Kjo detyrë është vetëm zbatim konsekuent i parimit të ndërgjyqësimit lojal, sipas të cilit pala është detyruar të paraqesë krejt materialin procedural. Në rastet kur pala nuk e parashtron dokumentin, rriten gjasa e mosprovimit të thënieve në të cilat ajo e mbështet kërkesën e vet. Kur dokumenti ka rëndësi për të provuar pretendimet e një palë, po ndodhet në dorën e palës tjetër kundërshtare, gjykata me kërkesën e palës së interesuar, kur e gjenë me vend kërkimin, urdhëron paraqitjen e këtij dokumenti. Edhe në raste të tilla për ligdhënësin ka qenë vendimtare parimi se nga palët duhet kërkuar paraqitjen e plotë të materialit procedural. Mirëpo, ligji i jep të drejtë palës që ta refuzojë dorëzimin e dokumentit në qoftë se si dëshmitar do të kishte të drejtë të mos dëshmojë në lidhje me faktin lidhur me të cilin flet dokumenti. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit me të cilin pala është urdhëruar që të paraqesë dokumentin nuk është i mundur, sepse ajo nuk mund të detyrohet në mënyrë të drejtëperdrejtë për një sjellje të caktuar procedurale. Duke marrur parasysh të gjitha rrethanat, gjykata çmon se çfarë rëndësie ka fakti se pala refuzon të veprojë sipas vendimit, me të cilin është urdhëruar ta dorëzojë dokumentin. Në këtë drejtim nuk është me rëndësi se a refuzon pala dorëzimin e dokumentit apo e mohon se ai ndodhet te ajo.

Në bazë të LPK-së në tri raste është e detyruar pala kundërshtare që ta dorëzojë dokumentin në gjithësi:

---

<sup>124</sup> Po aty, neni 331, par. 2

<sup>125</sup> Po aty, neni 333

- a) Në qoftë se edhe ajo vet gjatë gjykimit e ka përmendur dokumentin me qëllim të provimit të ndonjë pretendimi të saj;
- b) Në qoftë se është fjala për dokumentin, të cilin ajo sipas ligjit është e detyruar ta dorëzojë apo ta tregojë, p.sh. dokumentin i cili është besuar për ruajtje ose që është bashkëpronësi e të dy palëve dhe
- c) Në qoftë se dokumenti, për shkak të përmbajtjes së tij konsiderohet si i përbashkët për të dy palët, p.sh., kontrata, testamenti.<sup>126</sup>

As në këto tri raste, gjykata nuk mund ta ekzekutojë me dhunë aktvendimin me të cilin palën e ka urdhëruar ta dorëzojë dokumentin me qëllim që të shfrytëzohet si mjet provues. Mirëpo, në bazë të rasteve të lartëcekura, kundërshtari i palës, te i cili ndodhet dokumenti, të drejtën që ti dorëzohet dokumenti mund ta realizojë duke ngritur padi të posaçme në procedurë kontestimore në të cilën gjykata me aktgjykim e detyron atë që paditësit t'ia dorëzojë dokumentin. Në qoftë se i padituri nuk ia dorëzon paditësit dokumentin vullnetarisht, kundër tij ky i dyti mund ta vërë në veprim procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm. Prandaj, nëse paraqitja e dokumenteve në gjykatë është e vështirë për arsye se ata janë të shumtë ose për shkak se vetëm një pjesë e tyre ka rëndësi për çështjen, ose për ndonjë shkak tjetër, gjykata mund të kërkojë t'i paraqiten vetëm pjesët e nevojshme të nxjerra të tyre, të vërtetuara rregullisht, ose të urdhërojë të bëhet këqyerje e dokumenteve në vendin e ndodhjes së tyre.<sup>127</sup>

#### **4.7 Kundërshtimi i vërtetësisë së dokumenteve**

Pala kundër së cilës është paraqitur si provë, vërtetësinë e dokumentit mund ta kundërshtojë në njërin nga këto mënyra: a) duke mohuar shkrimin ose nënshkrimin e saj në shkresën jopublike – private, b) duke deklaruar se nuk di që shkrimi ose nënshkrimi i përmbajtur në shkresën private të jetë i trashëgimlënësit të saj ose i personit prej të cilit ajo nxjerr të drejta dhe detyrime, dhe c) duke pretenduar se dokumenti publik ose privatë është falsifikuar. Në këto raste, gjykata vendos me kontrollimin e vërtetësisë së dokumentit, duke krahasuar shkrimin dhe nënshkrimin që ai përmban me atë të shkresave të tjera vërtetësia e shkrimit të të cilave nuk mund të kundërshtohet si p.sh., autobiografia, por kur nuk ka të tilla ose këto s'janë të

<sup>126</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 333

<sup>127</sup> Po aty, fq. 296.

mjaftueshme, krahasimi do të bëhet me shkrim ose me nënshkrim që pala kundërshtare vë para gjykatës. Krahasimi do të bëhet me anë ekspertësh për ekspertimin grafik të dokumenteve. Kontrolli i vërtetësisë së dokumenteve bëhet edhe me anë të pyetjes së dëshmitarëve që kanë dijeni se pala kundërshtare e ka nënshkruar dokumentin pasi ata e kanë parë vetë etj.

Pas kontrollimit të vërtetësisë së dokumentit, gjykata me aktvendim që jep gjatë gjykimit ose me vendim përfundimtar, shprehet nëse dokumenti është i vërtetë ose jo. Kur del se dokumenti nuk është i vërtetë, gjykata përjashton atë nga provat. Mund të kundërshtohen për falsifikim sikur dokumentet publike, ashtu edhe ato private. Duke u nisur nga objekti i falsifikimit dallojmë falsifikimin material dhe atë intelektual. Është material falsikimi i dokumentit me anë gërvishtjesh, fshirjesh, shtresash, korrigjimesh etj. P.sh., në një dëftesë për kthimin e një shume të hollash prej 1000 €, i interesuari duke shënuar shifrën 1 e shton detyrimin në 11.000 €. Është intelektual falsifikimi i dokumentit kur deklaramet dhe faktet e shënuara në të nga personi zyrtar ose jozyrtar nuk i përgjigjen së vërtetës.

Kur në gjykimin kontestimor provohet falsikimi i dokumentit të propozuar si mjet provues, gjykata e përjashton atë nga provat. Në të drejtën tonë procedurale goditja e një dokumenti për falsikim mund të bëhet si objekt kryesor i padisë atëherë kur padia mund të ngrihet për vërtetimin e autenticitetit (vërtetësisë) të një dokumenti qoftë ai publik apo jopublik.<sup>128</sup>

## 5. Dëshmitarët

Dëshmitar është personi i cili i jep gjykatës deklaratë në lidhje me perceptimin e fakteve në të kaluarën duke mos e dhënë mendimin e tij mbi faktin e perceptuar. Thëniet e dëshmitarëve janë njoftime të personave të paineduar për përfundimin e çështjes, të cilët bëjnë deklaramet për faktet për të cilat ata kanë dijeni dhe që kanë rëndësi për çështjen civile në shqyrtim. Kjo provë përfitohet nga gjykata duke respektuar formën procedurale të caktuar me ligj. Dëshmitari kufizohet vetëm në shfaqjen e përceptimit të tij shqisor, duke mos e dhënë mendimin e tij për faktin e perceptuar. Në sistemin tonë procedural provimi me dëshmitar lejohet në të gjitha rastet,

---

<sup>128</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.296



duke i përfshirë edhe ato në të cilat ligji kërkon shkresë për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik.

### 5.1 Zotësia për të qenë dëshmitar

Parimisht, çdo person, pa marrë parasysh moshën e tij, ka zotësi për të qenë dëshmitar dhe po që se thirret nga ana e gjykatës si dëshmitar ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes, e në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ka për detyrë edhe të dëshmojë. Si dëshmitarë mund të pyetën vetëm personat që kanë aftësi të japin informata mbi faktet që duhet të provohen. Në këtë drejtim të miturit nën katërmbëdhjetë vjeç mund të pyeten si dëshmitar vetëm kur thënie e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.<sup>129</sup> Gjithashtu, në zotësinë për të qenë dëshmitar nuk ndikon as fakti se a ka marrë njohuri, në lidhje me faktin, i cili duhet të provohet, rastësisht apo si i thirrur, personi që duhet të pyetet si dëshmitar. Personi i thirrur që si dëshmitar të jetë i pranishëm me rastin e lidhjes së një kontrate apo me rastin e hartimit të testamentit, quhet dëshmitar i thirrur (*testis rogatus*). Mund të dëshmojë sikurse ai që e ka perceptuar faktin drejtpërdrejt ashtu edhe ai që në lidhje me faktin vetëm ka dëgjuar nga të tjerët (*testis de auditur*).

Nuk mund të thirren dhe të pyeten si dëshmitarë palët në çështjen e tyre e as përfaqësuesit ligjor të palëve, por në veçanti përfaqësuesi me prokurë i palës mund të pyetet si dëshmitar në çështjen juridike të palës së përfaqësuar. Poashtu, nuk mund të thirren edhe të pyetën si dëshmitarë as personat që lëngojnë nga sëmundjet fizike dhe psiqike të cilët janë absolutisht të paaftë për të qenë dëshmitarë, sepse nuk janë në gjendje të perceptojnë dhe të kuptojnë drejtë faktet që kanë rëndësi për çështjen dhe të bëjnë dëshmi të rregullt, si dhe personat relativisht të paaftë për të qenë dëshmitarë siç janë të verbërit, por vetëm për faktet që perceptohen me anë të shikimit, të shurdhërit, por vetëm për faktet që perceptohen me anë të dëgjimit. Pra, i verbëri mund të pyetet si dëshmitar për faktet që perceptohen me anë të dëgjimit, ashtu sikurse i shurdhëri për faktet që perceptohen me anë të shikimit etj.

Ndërsa të miturit sipas çmuarjes së gjykatës, mund të dëgjohen si dëshmitarë, por në raste të tilla në vlerësimin e provave, duhet të kihen parasysh një sërë faktorësh psikologjikë të fëmijëve sikurse janë, prirjet e tyre për fantazi të tepruar, mundësia e ndikimit me fjalë nga më të

---

<sup>129</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 339 par . 3;

vjetrit, mungesa e përvojës për të kapur tiparet thelbësore të fenomenit apo ngjarjes etj.<sup>130</sup> Poashtu, në qoftë se, gjyqtarin duhet dëgjuar si dëshmitar në çështjen në të cilën vepron si gjyqtar, më parë duhet përjashtuar atë nga gjykimi.<sup>131</sup>

## **5.2 Detyrat e dëshmitarit**

Detyra e dëshmimit nënkupton detyrën e paraqitjes sipas thirrjes në gjykatë, atë të dhënies së deklaratës si dhe detyrën e thënies së të vërtetës. Kur e kërkon gjykata një gjë të tillë, dëshmitari është i detyruar që të betohet në lidhje me thënien e tij. Ndërsa, për dëshmi të rreme dëshmitari përgjigjet penalisht. Dëshmia konsiderohet e rreme sikurse kur dëshmitari jep deklarata për të cilat din se nuk pajtohen me perceptimet e tij ashtu edhe kur me qëllim e heshtë ndonjë rrethanë të cilën e di.<sup>132</sup>

Detyrën e dhënies së dëshmisë e kanë jo vetëm shtetasit e një shteti ku zhvillohet gjykimi veçse edhe të huajt që ndodhen në atë shtet. Personat që gëzojnë të drejtën e eksterritorialitetit (imunitetit diplomatik) dhe ata që ndodhen jashtë shtetit, mund të dëgjohen si dëshmitarë sipas rregullave për dhënien e ndihmës ndërkombëtare. Detyra e dëshmimit është, pra një detyrë e përgjithshme e të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë së organizuar.<sup>133</sup>

## **5.3 Përjashtimi nga detyra e dëshmimit**

Nga detyrimi i dhënies së dëshmisë parashihen përjashtime në interesin e përgjithshëm, apo në interesin e dëshmitarit dhe të personave me të cilët është në gjini. Duke pasur parasysh që, interesi shoqëror mund të kërkojë që të mos vërtetohen domosdo faktet relevante në një gjykim. Për rastet e tilla janë paraparë rregullat sipas të cilave gjykata nuk guxon ta pyesë si dëshmitar personin që me thënien e tij mund ta zbulojë ndonjë sekret ushtarak apo të shërbimit. Dëgjimi i personit të tillë si dëshmitarë lejohet vetëm pasi ta lirojë organi kompetent nga detyra e ruajtjes së fshehtësisë.<sup>134</sup> Në të kundërtën personi i tillë kryen vepër penale të zbulimit të sekretit zyrtar apo ushtarak. Edhe pse, me LPK nuk është paraparë asgjë lidhur me fshehtësinë

---

<sup>130</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.297

<sup>131</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 67, pika a;

<sup>132</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.298

<sup>133</sup> Po aty, neni 339.

<sup>134</sup> Po aty, neni 341.

profesionale, edhe pse zbulimi i saj gjithashtu përbën vepër penale. Andaj, kur organi kompetent i liron nga detyra e ruajtjes së fshehtësisë personale e detyruar për ruajtjen e saj, gjykimi zhvillohet me dyer të mbyllura, duke u marrë të gjitha masat e ndryshme për ruajtjen e fshehtësisë.<sup>135</sup>

## 5.4 Pyetja e dëshmitarëve

Ky veprim procedural zakonisht kryhet në seancë gjyqësore, por kur dëshmitari për shkak të sëmundjes ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të paraqitet para gjykatës, gjykata mund të vendosë që pyetja e tij të bëhet nga gjyqtari ose nga gjyqtari i porositur jashtë qendrës së vet. Në raste të tilla, pyetja e dëshmitarit bëhet para ditës së caktuar për seancën gjyqësore. Dëshmitari mund të thirret në gjykatë sipas propozimit të palës, të ndërhyrësit apo kryesisht nga gjykata. Pala apo ndërhyrësi që propozon thirrjen e një personi me qëllim që të dëgjohet si dëshmitar, duhet t'i tregojë rrethanat për identifikimin e tij si dhe faktet lidhur me të cilat duhet të dëshmojë ai. Dëshmitari mund të paraqitet në seancë gjyqësore me iniciativën e palës ose me anë të letërthirrjes së nxjerrë nga gjykata. Paraqitja në gjykatë në kohën e caktuar është detyrë e çdo qytetari që thirret nga gjykata, edhe në rast se nuk di asgjë në lidhje me çështjen juridike. Në rast se dëshmitari nuk e plotëson këtë detyrë, pa pasur ndonjë shkak të arsyeshëm, ndaj tij merren masa gjobitje dhe sjellje përdhunisht. Për këto pasoja dëshmitari paralajmërohet me anë të letërthirrjes.

Pyetja e dëshmitarëve fillon me marrjen e identitetit të tyre (emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, detyra që kryen, arsimi, profesioni, vendbanimi, etj). Pas kësaj, gjyqtari i shpjegon dëshmitarit detyrimin ligjor për të treguar gjithçka që ai di rreth çështjes, paralajmëron për përgjegjësinë penale që ka për dëshmi të rreme dhe e urdhëron të largohet nga salla e gjykimit, duke e porositur që të mos merret vesh me dëshmitarët tjerë. Poashtu, dëshmitarët merren në pyetje një nga një, në prani të palëve, por pa qenë të pranishëm ata që duhet të pyetën më vonë. Radha e pyetjes së dëshmitarëve caktohet nga gjyqtari. Dëshmitari i pyetur nuk mund të largohet nga salla e gjykimit pa lejen e gjykatës. Gjyqtari kërkon nga dëshmitari që lirisht ta parashtrijë atë që di lidhur me faktet për të cilat duhet të dëshmojë. Dëshmitarët përgjigjen gojarisht, por mund të kenë me vete shënime të shkruara kur flasin për çështje që kanë të bëjnë

---

<sup>135</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.299

me llogari (shifra të shumta) dhe me të dhëna të tjera që është vështirë të mbahen mend.<sup>136</sup> Çdo dëshmitar mund të pyetet rishtazi në prani të dëshmitarëve të tjerë, ose të ballafaqohet me ta për ta sqaruar dhe eliminuar kundërthëniet lidhur me faktet e rëndësishme.<sup>137</sup> Dëshmitari pyetet për gjendjen në fjalë se nga e di atë për të cilën dëshmon. Poashtu, edhe në rastet kur dëshmitari, i cili nuk e din gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi, pyetet me anë të përkthyesit, edhe pse ndoshta gjyqtari e di gjuhën e tij. Nëpërmjet përkthyesit të pranishëmve u lehtësohet ndjekja e bisedës me dëshmitarin. Kurse, dëshmitarit të shurdhër pyetjet i bëhen me shkrim, e në qoftëse ai është memec, gjykata kërkon nga ai që të përgjigjet me shkrim, por në pamundësi të kësaj mënyre, atij mund ti parashtrohen pyetjet edhe nëpërmjet personit, i cili është interpretues mund të merret vesh me dëshmitarin.<sup>138</sup>

## **Të drejtat e dëshmitarit**

Dëshmitari ka të drejtë që të respektohet dinjiteti i tij nga pjesëmarrësit në procedurë. Me dispozita dënuese dëshmitari është i mbrojtur nga fyerjet e të tjerëve. Këtë mbrojtje ai e gëzon ndaj palëve, ndërhyrësve, përfaqësuesve, përkthyesve, publikut si dhe ndaj dëshmitarëve të tjerë. Dëshmitari mund të kërkoj nga gjykata që në procesverbal të konstatohet fyerja që i bëhet nga të tjerët. Poashtu, dëshmitarët kanë të drejtë që të flasin në gjuhën amtare, të kërkojë leximin e procesverbalit gjyqësor ku janë shënuar thëniet e tyre dhe të kërkojnë shënimin me saktësi të thënieve që bëjnë. Dëshmitari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për kohën e punës së humbur lidhur me paraqitjen në gjyq, si dhe shpenzimet për udhëtim, fjetje dhe ushqim.

Dëshmitarit të thirrur nga gjykata i takon kjo e drejtë edhe në rast se nuk e pyet gjykata, pa marrë parasysh shkakun.<sup>139</sup> Dëshmitari duhet të kërkojë shpërblimin menjëherë pasi të merret në pyetje, sepse në të kundërtën e humb këtë të drejtë. Për të gjitha këto, gjykata është e obliguar ligjërisht që ta njoftojë dëshmitarin për benifitet e tij.<sup>140</sup> Në aktvendimin, me të cilin përcaktohen shpenzimet, gjykata konstaton se shuma e tyre duhet të paguhet nga paradhënia e depozituar. Në rast se ajo nuk është depozituar, gjykata e urdhëron palën që shumën e shpenzimeve t'ia paguajë

---

<sup>136</sup> Po aty, fq. 300

<sup>137</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 349

<sup>138</sup> Po aty, neni 354.

<sup>139</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.303

<sup>140</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 355

dëshmitarit drejtpërdrejt brenda afatit prej 7 ditësh. Në bazë të këtij vendimi dëshmitari mund ta iniciojë procedurën përmbarese, në qoftë se pala nuk e paguan vullnetarisht shumën e caktuar të shpenzimeve. Ankesa kundër aktvendimit për shpenzimet që duhet t'i paguhen dëshmitarit nuk shtyen ekzekutimin e tij.<sup>141</sup>

## 6. Ekspertët

Ekspertë janë personat që kanë njohuri të veçanta në fusha të ndryshme të shkencës, teknikës, prodhimit, artit e kulturës dhe që thirren nga gjykata për të dhënë mendime e vlerësime të përpikta për sende, veprimtari a për zgjidhjen e një çështjeje të ndërlikuar. Ekspertët japin mendimin e tyre të kualifikuar si për fakte të mëparshme ashtu edhe për fakte që ekzistojnë aktualisht. Eksperti konkluzionin e tij e jep me anë të aktit të ekspertimit. Ekspertimi është një mjet provues në gjykim, që përdoret në rastin kur për vërtetimin ose vlerësimin e një fakti, kërkohen njohuri të kualifikuara, p.sh. njohuri në fushën e mjekësisë, arkitekturës, të shkrimit etj.

Për dhënien e përgjegjës në pyetjet, në të cilat gjykata has gjatë gjykimit, shpeshherë është e nevojshme dijenia profesionale nga lëmi i shkencës, ekonomisë, mjekësisë, artit, apo nga ndonjë veprimtari tjetër shoqërore. Dhënia e ndihmës së tillë në të shumtën e rasteve qëndron në atë se ai ia bënë të mundur gjykatës konstatimin e faktit i cili është objekt i të provuarit. Marrjen e provës me anë të ekspertizës gjykata e cakton me vendim i cili duhet të përmbajë, (emrin, mbiemrin dhe profesionin e ekspertit, objektin e kontestit, vëllimin dhe lëndën e ekspertimit, afatin për paraqitjen me shkrim të konstatimit dhe mendimit). Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Mendimin e ekspertit gjykata e çmon lirisht, sikurse edhe provat tjera. Mirëpo, në praktikën gjyqësore, në të shumtën e rasteve gjykata e përvetëson mendimin e ekspertit. Dispozitat ligjore lidhur me ekspertimin në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe për interpretët gjyqësor.

Në varësi të degës së shkencës, teknikës, prodhimit, letërsisë, artit, kulturës etj. njohuritë e ekspertëve nevojiten për konstatimin e ndonjë fakti apo dhënien e mendimit lidhur me një fakt konkret, kemi shumë lloj ekspertimesh: mjekësor, psikiatrik, kimik, teknik, mjeko – ligjor, letrar, muzikor, etnografik, arkitektonik, kontabël etj. p.sh. eksperti mjeko – ligjor jep konkluzionin për shkallën e humbjes së aftësisë për punë nga një aksident, për vlerën e një ndërtese konkluzionin e

---

<sup>141</sup> Po aty, neni 355, par. 4

jep eksperti teknik etj. Me konstatimin e funksionimit të një makine eksperti e jep mendimin në lidhje me atë se a i ka kualitetet e kontraktuara, në bazë të kontrollimit mjekësor të një personi, ai e jep mendimin në lidhje me faktin se a i është zvogëluar aftësia e punonjësve nga lëndimi i caktuar dhe në ç’masë etj.<sup>142</sup>

## 6.1 Caktimi i ekspertit

Ekspertimi vendoset nga gjykata kryesisht ose mbi kërkimin e palëve, por gjithmonë pasi që të merret mendimi i tyre. Mendimin e ekspertit ose ekspertëve gjykata e vlerëson si çdo provë tjetër. Kur nuk e bind mendimin e tyre ajo duhet të arsyetojë mospranimin në vendimin përfundimtar. Para se eksperti të marrë detyrat, gjykata e fton atë të bëjë betimin se do t’i kryejë me nder detyrat e ngarkuara. Caktimi i një ose më shumë ekspertëve bëhet nga gjykata pasi merret mendimi i palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procesin civil. Sipas legjislacionit tonë, ekspertimi mund t’i besohet ndonjë institucioni profesional si, bie fjala, spitalit, laboratorëve kimike, fakulteteve etj.<sup>143</sup> Kurse, sipas Kodit Procedurës Civile të Shqipërisë, ekspertët zgjidhen nga personat që janë të specializuar për çështjen konkrete në gjykim dhe që janë të regjistruar në lista të veçanta të institucioneve apo të shoqatave.<sup>144</sup>

Për t’u pranuar kryerja e ekspertimit është e nevojshme që konkluzioni i ekspertit të ketë rëndësi për çështjen, si p.sh. në çështjen për pjesëtim pasurie vlerësimi i pasurisë dhe mënyra e ndarjes; në padinë për njohje ose kundërshtim atësie analiza e grupeve të gjakut etj. pa një ekspertim nuk mund të jetë kurrë e sigurt zgjidhja e çështjes nga gjykata. Mund të rezultoj p.sh. që babai i pretenduar të përjashtohet në mënyrë absolute. Gjykata në vendimin për kryerjen e ekspertimit duhet të përcaktojë objektin e ekspertimit, çështjet dhe rrethanat për të cilat do jepet mendimi nga eksperti. Për këtë gjykata duhet të dëgjojë më parë mendimin e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces. Para se të kryej ekspertimin eksperti ka të drejtë të njihet me materialet e çështjes dhe të marrë të dhëna nga palët që ai i quan të nevojshme. Mendimi i ekspertit jepet me gojë ose me shkrim. Me gojë jepet zakonisht mendimi kur ekspertimi bëhet në prani të gjykatës ose gjyqtarit. Në këto raste mbahet procesverbal i cili nënshkruhet nga eksperti.

---

<sup>142</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.304

<sup>143</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 358.

<sup>144</sup> Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, neni 80.

Ekspertimi i bërë pa praninë e drejtpërdrejtë të gjykatës hartohet në një raport të shkruar, në të cilin pasqyrohen edhe vërejtjet e kërkesat e palëve. Kur ekspertimi bëhet nga dy a më shumë ekspertë, këta mund të japin bashkarisht mendimin e tyre në qoftë se janë të një mendimi. Kur ekspertët kanë mendime të ndryshme, atëherë secili parashtron veçmas mendimin e tij. Në raste të tilla, si dhe kur ekspertimi ka mangësi ose është i paqartë, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve mund të kërkojë sqarime plotësuese ose edhe të urdhërojë një ekspertim të ri me ekspertë të tjerë. Shpenzimet për ekspertin caktohen nga gjykata dhe parapaguhet nga pala që i ka kërkuar. Por gjykata duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen pasurore të palëve, mund të ngarkojë njerën ose të dy palët që të paguajnë shpenzimet e ekspertit, pavarësisht se cila palë e ka kërkuar. Mendimi i ekspertit duhet të jetë i arsyetuar për çdo konkluzion.<sup>145</sup>

## **6.2 Përrjashtimi i ekspertit**

Përrjashtimi i një personi nga pjesëmarrja në gjykim si ekspert mund të kërkohet po për ato shkaqe për të cilat kërkohet edhe përrjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi konkret.<sup>146</sup> Prandaj, për shkak të rëndësisë që e ka mendimi i ekspertit me rastin e vendosjes meritore, ligji i ka paraparë masat që duhen marrë për sigurimin e paanësisë së tij. Kur palët kanë kundërshtim, nuk mund të marrë pjesë si ekspert në shqyrtimin e çështjes personi që është palë, bashkëshort, gjini ose krushqi e afërt me njerën nga palët, ai që ka interes në zgjidhjen e çështjes, ose është bashkëshort, gjini ose krushqi e afërt me një person që ka interes në zgjidhjen e çështjes etj.

Në qoftë se palët janë pyetur për personin e ekspertit para se të jetë emëruar ai, përrjashtimin e tij ato duhet ta kërkojnë që me atë rast. Në rastet tjera pasi t'ua njoftojë gjykata emrat e tyre, por para se të fillojë marrja e provës me anë të ekspertimit. Kërkesa për përrjashtim mund të bëhet edhe më vonë, por vetëm në qoftë se pala për shkakun e përrjashtimit ka marrë dijeni më vonë. Kërkesa për përrjashtim duhet të arsyetohet, kurse shkakun për përrjashtim duhet të bëhet i besueshëm. Për kërkesën vendos gjykata që shqyrton çështjen, gjyqtari i çështjes ose gjyqtari i porositur. Në rast se pala është njoftuar me shkakun e përrjashtimit pasi të jetë kryer ekspertimi, ajo ka të drejtë të bëjë prapësim. Në qoftë se konstatohet se ekziston shkakun për

---

<sup>145</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.304

<sup>146</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 360, par. 1

përrjashtimin e ekspertit, gjykata me aktvendim e shpallë të pavlerë ekspertimin dhe e urdhëron që të bëhet ekspertimi i ri me ekspert tjetër. Kundër aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përrjashtim nuk lejohet ankimi, kurse kundër atij me të cilin refuzohet kërkesa nuk lejohet ankim i veçantë, por vetëm i përrbashkët me atë kundër vendimit përrfundimtar.<sup>147</sup>

### 6.3 Ekspertimi

Si mjet provues gjykata mund të përrdorë edhe ekspertimin, duke e drejtuar vetë ose duke ia besuar atë një ekspert. Ekspertimi mund të bëhet nga gjykata për t'u siguruar për ekzistencën e një fakti, duke proceduar në riprodhimin e tij, duke urdhëruar të kryhen edhe riprodhime fotografike të objekteve, dokumentave dhe sendeve dhe kur është e mundshme edhe filmimin e tyre. P.sh. riprodhimi i njohjes së njeriut në errësirë në një distancë të caktuar, duke filmuar ose fotografuar objekte, sende ose dokumente në kushtet e pretenduara nga pala gjatë filmimit ose fotografimit të parë etj.<sup>148</sup> Përr caktimin e ekspertimit gjykata merr vendim në të cilin duhet të përrcaktohen: 1) objekti i ekspertimit; 2) rrethi i sendeve që do të shërbejnë si material për ekspertimin: si dhe 3) eksperti që ngarkohet me kryerjen e ekspertimit.

Me objekt të ekspertimit kuptohen çështjet (rrethanat) për të cilat do të japë mendim eksperti. Para se të përrcaktojë objektin e ekspertimit, gjykata duhet të dëgjojë edhe mendimin e palëve për rrethana që, sipas mendimit të tyre duhet të japë mendim eksperti ose për pyetjet rreth të cilave ai duhet të përrgjigjet. Para ekspertëve mund të shtrohen për të dhënë mendim vetëm ato rrethana faktike që i përrkasin qënies ose jo të fakteve të caktuara, shkaqeve të prejardhjes së tyre, qënies ose mungesës së lidhjes së përrcaktuar midis fakteve, etj. Por jo problem të karakterit juridik siç janë, bie fjala, përrcaktimi i faktit nëse ka ose jo detyrim i padituri ndaj paditësit, kush duhet të përrgjigjet për dëmin e shkaktuar etj, sepse problemet juridike në një kontest zgjidhen vetëm nga gjykata në bazë të ligjit. Çështjet për të cilat i kërkohet mendimi i ekspertit duhet formuluar qartas, në mënyrë të saktë dhe duhet të kenë lidhje me specialitetin e tij.

Ekspertit duhet t'i vihen në dispozicion materiale të plota, të cilat lypset të jenë të mjaftueshme për të dhënë mendim. Kur sipas gjykimit të ekspertit materialet ose rrethanat e çështjes janë të pamjaftueshme për të dhënë mendimin që i kërkohet, ai ka të drejtë të kërktojë t'i

---

<sup>147</sup> Po aty, neni 360, par. 5.

<sup>148</sup> Po aty, neni 289.



jipen materiale plotësuese ose të marrë dijëni për rrethanat e tjera të çështjes. Eksperti ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, të marrë pjesë në këqyrjen në vend, t'i propozojë gjykatës pyetjen e dëshmitarëve ose marrjen e ndonjë prove tjetër etj. Kështu, sepse nuk mund të ketë ekspertim të suksesshëm pa bashkëpunim midis gjykatës dhe ekspertit.<sup>149</sup> Kur janë thirrur disa ekspertë që janë të një mendimi, përfundimet e ekspertimit mund t'i parashtrijë njëri që caktohet prej tyre, në të kundërtën, kur ka kundërshtim ose ndryshim mendimesh midis ekspertëve, secili prej tyre duhet të parashtrijë mendimin e tij para gjykatës. Pasi të japin mendim, ekspertëve mund t'u bëhen pyetje nga palët dhe gjykata. Kur ekspertët janë më shumë se një dhe kërkojnë të meren vesh midis tyre duhet të lejohen nga gjykata. Kështu veprohet kur eksperti konstatimin (gjetjen) dhe mendimin e parashtron gojarisht në seancën për shqyrtimin kryesorë, ai prapëseprapë duhet të thirret për seancën kryesore me qëllim që në të gojarisht ta parashtrijë gjithë atë që e ka thënë në shkresë. Kur ka mundësi gjykata ua dërgon palëve shkresën që e përmban konstatimin dhe mendimin e ekspertit para se të fillojë seanca në të cilën do të shqyrtohet thënia e tij përkatësisht së paku 8 ditë para se të fillojë seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes.<sup>150</sup> Mendimin e tij eksperti gjithmonë duhet ta arsyetojë. Po qe se mendimi i dhënë nga ekspertët shihet se nuk është i plotë ose është i paqartë, si dhe kur midis ekspertëve ka mendime të ndryshme, gjykata me kërkesën e njëres nga palët ose kryesisht mund të kërkojë sqarime plotësuese po nga ata ekspertë ose mund të urdhërojë ekspertim të ri, po nga ata ekspertë ose duke thirrur ekspertë të tjerë.<sup>151</sup> Ky vendim i gjykatës duhet të jetë i arsyetuar.

Kur mendimi i ekspertit shprehet me gojë duhet të shënohet në procesverbalin gjyqësor dhe të nënshkruhet nga eksperti. Në qoftë se është urdhëruar eksperti që atë ta shprehë me shkrim, shkresa i bashkangjitet procesverbalit. Kur ekspertimi kryhet nëpërmjet gjyqtarit të porositur, i cili veprimet e ekspertit, konstatimin dhe mendimin i ka shënuar në procesverbal, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor procesverbali i tillë lexohet. Në vartësi nga karakteri dhe objekti i ekspertimit, ai mund të kryhet në gjykatë ose jashtë saj. Ekspertimi nuk mund të bëhet para gjykatës kur është e pamundur ose e vështirë që objekti, i cili do të ekspertohej, të silllet në gjykatë. Në rast të tillë ekspertimi bëhet në vendin ku ndodhet objekti, duke u njoftuar edhe palët për ditën dhe orën e ekspertimit. Mendimi i ekspertëve nuk është i detyrueshëm për

---

<sup>149</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.306

<sup>150</sup> Po aty, neni 367.

<sup>151</sup> Po aty, neni 366 par.1.

gjykatën. Edhe pse gjykata nuk ka dijëni profesionale të nevojshme për sqarimin e rrethanave të caktuara, ajo mund të mos e aprovojë konstatimin dhe mendimin e ekspertit në qoftë se qëndrimet e shprehura të tij nuk mund t'i qëndrojnë kritikës së bazuar në rregullat e përvojës dhe të logjikës. Kur gjykata ka mendim të kundërt ose të ndyshëm nga ai që japin ekspertët, ajo duhet ta arsyetojë hollësisht dhe qartas këtë kundërshtim ose ndryshim mendimi në vendimin përfundimtar ose vendimin që jep gjatë gjykimit.<sup>152</sup> Kjo do të thotë se mendimi i ekspertëve, sipas së drejtes sonë, nuk mund të mbivlerësohet në krahasim me llojet tjera të provave. Ai mund të rrëzohet edhe me prova të tjera, sepse te ne eksperti nuk konsiderohet as “dëshmitar shkencor” e as “gjyqtar shkencor”. Edhe mendimi i ekspertëve, pra në të drejtën tonë procedurale, do të çmohet nga gjykata sipas rregullave të përgjithshme të parapara për vlerësimin e provave, domethënë në bazë të bindjes së brendshme të gjykatës, të mbështetur në ndërgjegjen juridikë dhe të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kur gjykata mendimin e shfaqur nga eksperti e rrëzon me prova të tjera, nuk ka nevojë që ta urdhërojë ekspertimin e ri. Në bazë të gjithë kësaj që u tha mund të përfundojmë se nga aftësia e gjyqtarëve që t'ia nënshtrojnë kritikës konstatimin dhe mendimin e ekspertit varet shkalla e pavarësisë së tyre nga qëndrimi i ekspertëve.

Eksperti është i detyruar të paraqitet kur ta thërrasë gjykata dhe të japë mendim të saktë për çështjet që është thirrur.<sup>153</sup> Sipas thirrjes së gjykatës duhet të veprojë edhe eksperti që mendon se nuk ka dijëni apo mjete për ta kryer ekspertimin por edhe ai që mendon se për ndonjë shkak tjerër nuk ka detyrë të ekspertojë. Eksperti ka detyrë që konstatimin dhe mendimin ta parashtrijë me ndërgjegje dhe në pajtim me rregullat e shkencës dhe të profesionit të tij. Pasi që eksperti, me dallim nga dëshmitari, është i zëvendësueshëm, sepse zakonisht ekzistojnë më tepër persona që kanë dijëni për vlerësimin profesional të fakteve që ekzistojnë në momentin e ekspertimit, kundër tij mund të shqiptohen vetëm dënime me të holla. Eksperti pra as nuk mund të sillet përdhunisht në gjykatë e as të burgoset në qoftë se i shkelin detyrat e caktuara nga gjykata në bazë të ligjit. Në rast se eksperti nuk paraqitet në gjyq pa shkaqe të justifikuara, gjykata në bazë të neni, 293 par.1 e dënon me gjobë deri me 1.000 Euro. Pasi që eksperti është i detyruar të japë mendim para gjykatës, ai nuk mund të refuzojë shfaqjen e mendimit pa pasur ndonjë shkak të arsyeshëm. Kur ai refuzon ta kryejë detyrën pa arsye, gjykata mund ta dënoj me

---

<sup>152</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.307

<sup>153</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 362.par.1.

gjobë ashtu si u theksua më lartë deri në 1.000 Euro. Në qoftë se eksperti jep mendime të rreme para gjykatës, dënohet penalisht, sikurse edhe dëshmitari për dëshmi të rreme.

Për këtë arsye gjyqtari, para se të fillojë pyetjet e ekspertëve dhe pasi të sigurohet për indentitetin e tyre i paralajmëron ata se duhet të shfaqin mendime në pajtim të plotë me rrethanat e çështjes dhe me njohuritë e posaçme për të cilat thirren, duke u njoftuar njëkohësisht edhe për pasojat që ka mosdhënia pa arsye e mendimit, si dhe dhënia e mendimit të rremë. Vendimin për gjobitjen gjykata mund ta revokojë në qoftë se eksperti më vonë e justifikon mosardhjen në gjykatë apo pranon ta kryejë ekspertimin nën kushtet e nenit 292.4 të LPK-së. Edhe eksperti, sikurse edhe dëshmitari, u përgjigjet palëve për dëmin që ka shkaktuar me mosparaqitjen e pajustificuar apo me mospranimin që të emrohet ekspertë. Me kërkesën e palëve gjykata mund ta ngarkojë ekspertin që të paguajë shpenzimet të cilat ai ua ka shkaktuar me mosardhje të pajustificuar apo me refuzim të ekspertimit. Vendimi i formës së prerë i bazuar në mendimin e rremë të ekspertit mund të goditet me kërkesën për përsëritjen e gjykimit.<sup>154</sup>

#### **6.4 Përkthyesi dhe interpreti**

Këta subjekt të procesit kontestimor i ndihmojnë gjykatës që të komunikojnë pa pengesa me pjesëmarrësit në gjykim që nuk e din gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi, përkatësisht që janë të shurdhët apo memec, etj. Pyetja e palëve dhe e dëshmitarëve me anë të përkthyesve apo interpretëve (që janë një lloj ekspertësh), është e domosdoshme edhe kur gjykata mund të merret vesh me ta pa ndihmën e këtyre personave. Kjo detyrë e gjykatës është paraparë me siguri me qëllim që edhe pjesëmarrësit tjerë në gjykim të jenë në gjendje ta ndjekin bisedën që zhvillohet lidhur me çështjen. Në qoftë se palët nuk e dinë gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore, atyre u sigurohet përkthyesi i cili u ndihmon që ta ndjekin bisedën e të tjerëve lidhur me çështjen si dhe që të kryejnë vetë veprime procedurale në gjuhën e tyre.<sup>155</sup>

---

<sup>154</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.308

<sup>155</sup> Po aty, fq.309

Poashtu, dispozitat ligjore lidhur me ekspertët dhe ekspertimin në mënyrë adekuate zbatohen edhe lidhur me përkthyesit dhe interpretët dhe të drejtat ose detyrat që i kanë në procedurën kontestimore.<sup>156</sup>

## **7. Palët si mjet provues**

Kur palët shërbejnë si mjet provues, roli i tyre është i ngjashëm me atë të dëshmitarit. Kjo provë ka karakter subsidiar, sepse gjykata mund ta përdorë (por nuk është e obliguar) në çoftë se nga provat e tjera nuk ka mundur të formojë bindjen e saj për saktësinë e fakteve, apo kur nuk ekzistojnë prova të tjera. Gjykata vendosë ta marrë në pyetje vetëm njëërën nga palët, në qoftë se është e bindur se tjetra nuk ka dijeni për faktin kontestues. Ky mjet provues nuk është i besueshëm, sepse interesi personal i palëve ndikon që ato mos ta flasin gjithmonë të vërtetën. Nga kjo arsye është paraparë se pala nuk është e detyruar të pranoj rolin e mjetit provues. Mirëpo, kur e pranon një gjë të tillë, pala përgjigjet penalisht për dhënien e dëshmisë së rreme. Duhet patur kujdes të veçantë me rastin e administrimit të kësaj prove edhe për faktin se të dy palët kundërshtare njëkohësisht duhet ftuar me ftesa të posaçme për tu marrë në pyetje në cilësinë e palëve dhe duhet njoftuar se në rast të mosardhjes së tyre pala kundërshtare do të merret në pyetje dhe se në një situatë të tillë kur palët nuk i përgjigjen ftesës së gjykatës ndaj tyre nuk mund të përdoret kurrfarë mase shtrëngimi e as që të njëjtat të detyrohen për të dhënë deklaratë.<sup>157</sup>

### **7.1 Palët si dëshmitar**

Palët janë burim kryesor dhe i sigurt i dijenisë lidhur me faktet relevante të çështjes juridike. Ato, zakonisht, më së miri e dinë gjendjen faktike për të cilën mbështesin pretendimet e tyre. Gjithashtu, atyre më së miri iu kujtohen ngjarjet, dukuritë, gjendjet e sendeve apo të njerëzve etj, të rëndësishme për themelimin dhe zhvillimin e një raporti civil. Mirëpo, ky mjet provues nuk mund të jetë i besueshëm, sepse palët nuk i tregojnë drejt faktet, veçse në mënyrën e cila i përgjigjet interesit të tyre që ta fitojnë gjykimin. Mund të ndodhë që përveç deklaratave të

---

<sup>156</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 372

<sup>157</sup> <https://businessandlegal.ie/evidence-in-civil-legal-actions-what-you-need-to-know>

palëve gjykata të mos ketë kurrfarë burimi tjetër të informatave lidhur me faktet relevante. P.sh., paditësi pretendon se të paditurit ia ka dhënë një shumë të hollash hua, pa praninë e askujt dhe pa kurrfarë dokumenti, e ky i fundit e mohon një gjë të tillë. Në sistemet e vjetra procedurale, në mungesë të mjeteve provuese, dijenia e palëve lidhur me faktet shfrytëzohej brenda institutit të betimit të palëve. Në sistemet bashkëkohore një gjë e tillë bëhet duke u pyetur palët si dëshmitarë në çështjen e tyre. Prapëseprapë, edhe në këto sisteme procedurale ekzistojnë të tilla (si p.sh, ai francez dhe italian) ku betimi i palëve ka vlerë të provës së pamohueshme.

Me anë të këtij mjeti provues palët bëhen instrument për zbulimin e së vërtetes sikurse edhe dëshmitarët. Mirëpo, kundër palëve nuk mund të merren masa shtrënguese me qëllim që të dëshmojnë në çështjen e tyre. Kur pala thirret për t'u pyetur si dëshmitarë, pala mund të vijë, por mund edhe të mos vijë në seancë. Gjatë pyetjes ajo mund të përgjigjet, por edhe mund të mos përgjigjet në pyetjet e gjykatës apo të palës kundërshtare. Mirëpo, në qoftë se pranon të japë deklaratë, ajo bëhet në një mënyrë dëshmitarë dhe, si e tillë, ka për detyrë të flasë të vërteten. Për deklaratë të rreme ajo përgjigjet penalisht, por vetëm në qoftë se vendimi i gjykatës është bazuar në një deklaratë të tillë. Kur pala nuk paraqitet në gjykatë apo kur nuk përgjigjet në pyetjet e gjykatës apo të kundërshtarit, gjykata lirisht e vlerëson domethënien e sjelljes së saj të tillë. Provën me anë të dëgjimit të palëve duhet dalluar rreptësisht nga i ashtuquajtimi dëgjim informativ i tyre. Me të dytin gjykata i sqaron pretendimet e paqarta dhe i plotëson ato që janë të mangëta. Për këtë qëllim gjykata mund ta thërret palën në seancë edhe kur e ka përfaqësuesin me prokurë. Me veprimet e llojit të dytë pala e shprehë vullnetin se në cilin drejtim duhet shqyrtuar kontestin dhe si duhet zgjidhur atë. Kur e merr provën me anë të dëgjimit të palëve gjykatës i intereson vetëm dijenia e tyre në lidhje me faktet dhe ngjarjet që janë zhvilluar jashtë procesit gjyqësor dhe zakonisht para se të ketë filluar ai të zhvillohet. Me atë rast gjykata e pyet palën prej nga e di atë që deklaron, sepse një gjë e tillë është me rëndësi për vlerësimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratës së saj. Me qëllim të konstatimit të fakteve gjykata mund ta marrë në pyetje edhe palën që nuk ka zotësi për të vepruar.<sup>158</sup>

Sipas ligjit, prova më anë të dëgjimit të palëve ka karakter subsidiar: gjykata mund ta përdorë (por nuk është e detyruar) në qoftë se nuk ka prova të tjera, apo në qoftë se nga provat e tjera nuk ka mundur ta formojë bindjen e saj mbi vërtësinë e fakteve në të cilat palët e

---

<sup>158</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq.309

mbështesin ndonjë kërkesë të tyre.<sup>159</sup> Marrja e kësaj prove nuk është e lejueshme në procedurën e sigurimit të provës (paraprova). Në LPK të vitit 1976 nuk parashihet më ndalimi i marrjes së kësaj prove në procedure sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit. Kjo ndalesë parashihej në nenin 421. parag 4. të sa me të rrallë të këtij mjeti provues jo aq të besueshëm. Nuk ka dyshim se me kufizimin në fjalë është çenuar në një masë parimi i çmuarjes së lirë të provave nga gjykata,<sup>160</sup> i cili përmban në vete autorizimin e gjykatës që lirisht ta bëjë zgjedhjen e mjeteve provuese për vërtetimin e fakteve vendimtare.<sup>161</sup> Të përkujtojmë se gjykata mund t'i pyesë si dëshmitarë edhe të miturit e edhe ata me të meta psikike apo fizike për faktet që kanë mundur t'i perceptojnë e që mund t'i reprodukojnë. Në shkencë me të drejtë është shprehur mendimi se dispozitën për supsidiaritetin e këtij mjeti provues duhet kuptuar më tepër si rregull instruktive, si sugjerim gjykatës që të mos ngutet me marrjen e tij sa herë që ka mundësi faktet relevante t'i konstatojë me anë të provavë të tjera. Kështu në dispozitën e dëgjimit të palëve del në vend të parë në krahasim me të tjerat. I tillë është rasti, p.sh., me kontestin në të cilin objekt shqyrtimi janë raportet, zhvillimi i të cilave u është i njohur vetëm palëve. Askush më mirë se vetë bashkëshortët nuk i dinë faktet dhe rrethanat që janë relevante në gjykimin për zgjidhjen e martesës.

## **7.2 Marrja e provës me anë të dëgjimit të palëve**

Marrja e kësaj prove bëhet duke u dëgjuar të dy palët. Mirëpo, gjykata mund të vendosë që ta dëgjojë vetëm një palë: 1) Në qoftë se konstaton se pala tjetër nuk din asgjë për faktet që duhet të provohen me këtë mjet provues dhe 2) në qoftë se konstaton se palën tjetër nuk mund ta dëgjojë për shkak të pengesave objektive apo juridike. Këtë vendim gjykata mund ta jepë vetëm pasi të ketë konstatuar se pyetja e të dy palëve, për shkaqet e përmendura në pikat e sipërme, nuk është e mundur.<sup>162</sup> Në qoftë se në seancën për marrjen e provës nuk vjen njëra nga të dy palët e thirrura gjykata e merr këtë provë duke e dëgjuar atë që ka ardhur. Në qoftë se njëra nga të dy palët refuzon të merret në pyetje, gjykata e merr provën duke e dëgjuar vetëm palën tjetër. Pasi që pala me pazotësi procedurale nuk themelon personalisht raportet juridike, është gjë normale që në vend të saj të merret në pyetje përfaqësuesi i saj ligjor i cili ka vepruar në emër dhe llogari

---

<sup>159</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 373

<sup>160</sup> Po aty, neni 8.

<sup>161</sup> Po aty, neni 319 par. 3

<sup>162</sup> Po aty, neni 375

të palës së tillë me rastin e themelimit të raportit lidhur me të cilin ka lindur kontesti.<sup>163</sup> Mirëpo, në qoftë se pala e tillë ka aftësi që të perceptojë dhe reprodukojë faktet relevante gjykata mund të vendosë që ta dëgjojë atë në vend të përfaqësuesit ligjor apo krahas tij.<sup>164</sup> Për personin juridik duhet pyetur përfaqësuesin e tij të caktuar me ligj apo me aktin e përgjithshëm normative.<sup>165</sup>

Përfaqësuesi me prokurë nuk mund të dëgjohej në vend të palës së përfaqësuar. Kjo vlen edhe për avokatin publik si përfaqësues. Në rast të bashkëndërgjyqësisë unike, kur vendoset marrja e provës me anë të dëgjimit të palëve, të gjithë bashkëndërgjyqësit duhet dëgjuar si palë, e jo disa nga ta si dëshmitarë. Po kjo rregull vlen edhe kur kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësit të tjerë material, në qoftë se marrja në pyetje bëhet me qëllim të konstatimit të fakteve me rëndësi për dhënien e vendimit meritor i cili u përket të gjithë bashkëndërgjyqësve. Kur bashkëndërgjyqësia është e thjeshtë, çdonjëri nga bashkëndërgjyqësit mund të dëgjohej si dëshmitarë në çështjen juridike të të gjithë bashkëndërgjyqësve të thjeshtë, atëherë të gjithë ata duhet të dëgjohej si palë.

Ndërhyrësin e thjeshtë (të zakonshëm) duhet marrë në pyetje si dëshmitarë, e jo si palë, në qoftë se din për faktet që duhet t'i vërtetojë gjykata. Në qoftë se ndërhyrësi në gjykimin e të tjerëve e ka pozitën e bashkëndërgjyqësit unik, atëherë dëgjimi i tij mund të bëhet vetëm në cilësi të palës e jo të dëshmitarit. Marrja e provës me anë të dëgjimit të palës bëhet sipas propozimit të palës apo kryesisht nga gjykata. Marrja e saj urdhërohet zakonisht me anë të aktvendimit të posaçëm për marrjen e provave, sepse ajo vjen në konsiderim vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha burimet e tjera informative. Me anë të letërthirrjes pala paralajmërohet se mungesa e saj nuk e pengon marrjen e provës duke u dëgjuar pala tjetër. Letërthirrja i dërgohet palës sipas rregullave që vlejné për komunikimin personal.<sup>166</sup> Edhe më parë është thënë se gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, çmon lirisht se çfarë domethënie ka fakti se pala nuk është paraqitur në seancë, apo se nuk ka dashur të jepë deklaratë.

Kjo provë mund të merret nga gjyqtari i çështjes apo nga gjyqtari i porositur vetëm në qoftë se pala për shkaqe të paevitushme nuk mund të paraqitet në gjykatë, ose në qoftë se ardhja e saj do të shkaktonte shpenzime tepër të mëdha. Dispozitat për marrjen e provës me anë të dëshmitarit zbatohen edhe në marrjen e provës me anë të dëgjimit të palëve, por vetëm në qoftë

---

<sup>163</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 311

<sup>164</sup> Po aty, neni 375, par. 2.

<sup>165</sup> Po aty, neni 375, par. 3

<sup>166</sup> Po aty, neni 376, par.1

se në lidhje me këtë mjet provues me ligj nuk është paraparë ndonjë gjë tjetër.<sup>167</sup> Kështu, për shembull, nga pala nuk mund të kërkohet betimi, e as të detyrohet për ardhje në seancë apo të detyrohet për dhënien e deklaratës.<sup>168</sup> Dispozitat e LPK-së me të cilat është rregulluar marrja e provës me anë të dëshmitarëve aplikohen edhe me rastin e marrjes së provës me anë të dëgjimit të palëve, po qe se për dëgjimin e palëve nuk është parashikuar shprehimisht edhe posaçërisht diç tjetër.<sup>169</sup>

---

<sup>167</sup> Po aty, neni 372

<sup>168</sup> Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017, fq. 312

<sup>169</sup> Po aty, neni 378



## Konkluzioni

Në këtë kërkim shkencor është analizuar barra e provës në procedurën kontestimore dhe natyra e saj juridike e rregullave mbi barrën e provës si institut shumë i rëndësishëm në procesin gjyqësor civil.

Përcaktimi se cila palë bartë barrën e provës në çështjet civile shpesh mund të jetë një detyrë e vështirë. Ajo që kërkohet është shqyrtimi i natyrës thelbësore të shkaktarit të veprimit të paditësit dhe mbrojtjes në dispozicion, në vend të thjeshtë të përdorimit të formës në të cilën janë përcaktuar rregullat ligjore ose shkaqet e veprimeve të krijuara me ligj. Dallimi duhet të nxirret midis barrës ligjore, prova dhe taktikave të provës, dhe në rastet e pasigurisë duhet pasur parasysh konsideratat praktike.

Gjykata Supreme e SHBA-së e ka përcaktuar barrën e provës si barrë e bindjes. Duke vepruar kështu, Gjykata e ka dalluar atë nga prodhimi i ngarkesës, ndonjëherë i referuar si barrë e shkeljes. Megjithatë, disa Gjykata përdorin termin e barrës së provës pa përshkrim të mëtejshëm kur i referohen barrës së bindjes apo asaj të prodhimit, të cilën ata e konsiderojnë element të ndarjes të barrës së provës.

Ende Gjykatat e tjera dallojnë midis tyre duke iu referuar barrës së bindjes si barrë e plotë e provës dhe ajo e prodhimit si barrë fillestare e provës.

Ato gjithashtu janë koncepte të ngjashme siç ilustron nga fakti se çështja nëse është përmbushur barra e bindjes duhet të vendoset vetëm nëse të dyja palët kanë përmbushur barrën e prodhimit. Duke parë këto ngarkesa si koncepte të ndara, por të ndërlidhura, largon shumë nga konfuzionet që nganjëherë e rrethon konceptin e barrës së provës. Poashtu, në lidhje me barrën e bindjes dhe të prodhimit është i nevojshëm edhe standardi i provës për të vërtetuar faktet e pretendimit të mbrojtjes afirmative në fjalë në raste të veçanta, p.sh. në rastet e kërkesave civile dhe mbrojtjen afirmative të tyre, këto fakte duhet të ekzistojnë me anë të përputhshmërisë së provave, një standard që kërkon gjetjen e faktit të nxjerrur nga provat e parapara.

Poashtu, edhe mjetet provuese kanë rol të rëndësishëm në procesin civil që zhvillohet në gjykatë. Provat shkresore në procesin civil janë çdo objekt material në të cilin është fiksuar me shenja të shkruara mendimi i njeriut, të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e një kontesti. Ligji i Procedurës Kontestimore të Republikës së Kosovës i dallon shkresat publike nga shkresat tjera. Shkresat tjera kanë dallim nga shkresat publike lidhur me qenien e saj si provë e plotë për faktin se kjo e fundit merr këtë efekt provues nga organi shtetëror ose personi i ngarkuar me veprimtari

publike që e ka hartuar. Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike.

Funksioni i shkresave tjera si provë bëhet i qartë kur pala kundërshtare në shpjegimet e tij mohon ndonjë detyrim ose deklarinimet në përmbajtjen e shkresës. Për fuqinë provuese të një shkresë rëndësi ka individualizimi i personit që ka shprehur mendimet në shkresën dhe kjo paraqet vështirësitë e saj. Provat si akte publike dhe shkresat tjera paraqiten në gjykatë me vendim të ndërmjetëm.

Ndryshe nga prova me dëshmitar apo ekspertimi, paraqitja e provave shkresore në gjykatë bëhet në procedurë të thjeshtë. Ato i dorëzohen gjykatës nga palët apo pjesëmarrësit e tjerë në gjykim dhe bëhen pjesë e lëndës gjyqësore. Dokumentet provuese janë prova që duhet të bashkangjiten kërkesëpadisë me rastin e dorëzimit të saj në gjykatë. Që shkresat e paraqitura pranë gjykatës të jenë efektive për procesin gjyqësor duhet të merren nga palët sipas ligjit përkatës në të kundërtën ato nuk sjellin pasoja juridike dhe konsiderohen nga gjykata si të pavlefshme.

## Rekomandimi

- Ti kushtohet rëndësi dhe hapësirë ligjore barrës së provës në legjislacionin e Republikës së Kosovës;
- Barra e provës të trajtohet si detyrë eskuzive e palëve për paraqitjen e provave;
- Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me rendin juridik te vendeve te zhvilluara si Austria, Gjermania, Franca, meqenëse bëjnë pjesë në sistemin Civil Law;
- Trajtimi më i gjerë i rregullave për barrën e provës dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore të Republikës së Kosovës. Duhet të trajtohen çështjet e tilla si: mënyrën mbi marrjen e provës, natyrën juridike të saj, mjetet provuese, procedimi provues, koha e paraqitjes së provave, marrja dhe çmuarja e provave si dhe sigurimi i paraprovës, etj.
- Studimi i barrës së provës në procedurën kontestimore dhe natyrën e rregullave mbi barrën e provës në nivel krahasues ndërkombëtar.

## **Bibliografia**

### **Tekste, monografi, artikuj shkencor,**

1. A different standard may, of course, be imposed by statute in civil cases, as with the Repatriation Act 1920 (Cth) which imposes the criminal standard on the Repatriation Commission. See *Repatriation Commission v Law* [1981] HCA 57; (1981) 36 ALR 411; *Repatriation Commission v Byrne* (1981) 40 ALR 296; *Repatriation Commission v Perrot* [1984] FCA 139; (1984) 53 ALR 690.
2. *Alaska Dept. of Env't Conversation v. Env't Prot. Agency*, 540 U.S 461. 470. N.17 (2004)
3. *Andreson v. Liberty Lobby, Inc*, 477 U.S 242, 253, (186)
4. *Bosworth St.*, 236 F.3d at 55; *In re Anthem Cmtys.*, 267 B.. at 871.
5. *Bruner v. Office of Pers. Mgmt.*, 996 F. 2d, 290, 293
6. *Bruner*, 996 F.2d at 292
7. *Bruner*, 996 F.2d at 293; *Samuels*, 112 F.Supp.2d at 467.
8. *Celotex Corp. v. Catrett*, 477 U.S. 317. 330-31 (1986) (dissenting op.).
9. *Cohen*, *The Probable and the Provable*, above n89 at 75.
10. *Concrete Pipe and Prods . of Cal., Inc v. Constr. Laborers Pension Trust for S.Cal.*, 508 U.S.602.622 (1993)
11. *Concrete Pipe and Prods.*, 508 U.S at 630; *United Statesv.Santoro*, 866 F. 2d 1538, 1544 (4<sup>th</sup> Cir 1989).
12. *Coppleson v FCT* [1928] *ArgusLawRp* 106; (1981) 34 ALR 377.
13. *Director, Office of Workers' Comp. Programs v. Greenwich Colliers*, 512 U.S 267, 272 (1994).
14. *El v. Septa*, 479 F.3d, 232, 237, n.6 (3<sup>rd</sup> Cir.2007)
15. *El*, 479 F.3d 237 n.6; *Bruner*, 996 F.2d at 293.
16. *El*, 479 F.3dat 237 n.6.
17. *Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile – procedura kontestimore, Prishtinë, 2017*
18. *Fed R, Evid*, 301; *McCann*, 458 F.3d at 287.
19. *Greenwich Colliers*, 512 U.S at 272.
20. *In re North St. Access. Ltd. P'ship*, 184 B.R. 1,7 (Bank. D. Mas. 1995)

21. Instituti Gjyqësor i Kosovës, Doracaku i gjyqtarëve për procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2016, fq. 231,
22. Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë, 2010
23. Keller Brass Co. v Cont'l Brass Co., 862 F.2d 1063,1066 (4<sup>th</sup> Cir 1988)
24. Lisbon Contractors, 828 F.2d at 765; Samuel, 112 F. Supp.2d at 467.
25. Martinelli, 196 F.3d at 428; United States v. 194 Quarker Farms Road, 85 F.3d 985, 990 (2<sup>nd</sup> cir 1996), cert. denied sub nom, 519 U.S 932 (1996).
26. Matter of Palmisano, 70 F.3d 483, 485 (7<sup>th</sup> Cir. 1995(. cert, denied, 517 U.S 1223 (1996)
27. Mathews v. Eldridge, 424 U.S. 319 (1976).
28. McCann v. Newman Irrevocable Trust, 458 F.3d 281. 287 (3d. Cir, 2006); In re Britt 199 B.R. 1000. 1008 (Bank N.D Ala, 1996).
29. Moore, 318 F.3d at 566; Samuel, 112 F.Supp.2d at 467
30. Moore, 318.F.d at 566; Simpson, 770 F.2d at 503; Auburndale State Bank v. Dairy Farm Leasing Corp., 890 F.2d 888, 893 (7<sup>th</sup> Cir. 1989).
31. Nat'l Bus.Consultants, 376 F.3d at 322.
32. Nat'l Commc'ns, 283 F.3d at 130-31.
33. Pardo, M.S. and R.J. Allen, 2008, "Juridical Proof and the Best Explanation", Law and Philosophy, 27: 223–268.
34. Pennsylvania, where substantially every presumption recognized by the courts does shift the "risk of persuasion.
35. Presumptions sustained include Hawker v. New York, 170 U.S. 189 (1898) (person convicted of felony unfit to practice medicine); Hawes v. Georgia, 258 U.S. 1 (1922) (person occupying property presumed to have knowledge of still found on property); Bandini Co. v. Superior Court, 284 U.S. 8 (1931) (release of natural gas into the air from well presumed wasteful); Atlantic Coast Line R.R. v. Ford, 287 U.S. 502 (1933) (rebuttable presumption of railroad negligence for accident at grade crossing). See also Morrison v. California, 291 U.S. 82 (1934).
36. Prickett v.United States, 111 F.Supp. 2d 1191. 1192. (M.D. Ala. 2000) aff'd. 268 F.3d. 1066 (5<sup>th</sup> Cir 2001).

37. Samuel v. Ford Motor Co 122 F. Supp. 2d 460, 467 (D.Md. 2000), aff'd, 95 F. App.x 520 (4<sup>th</sup> Cir.2004); Lisbon Contractors, Inc. v. United States 828 F.2d 759,765 (Fed.Cir 1987); In re Anthem Cmtys/RBG,LLC,267 B.R,867, 872 (Bank.D.Colo 2001).
38. Samuel, 112 F.Supp.2d at 467.
39. Santosky v. Kramer, 455 U.S. 745 (1982). Four Justices dissented, arguing that considered as a whole the statutory scheme comported with due process. Id. at 770 (Justices Rehnquist, White, O'Connor, and Chief Justice Burger). Application of the traditional preponderance of the evidence standard is permissible in paternity actions. Rivera v. Minnich, 483 U.S. 574 (1987).
40. Schaffer, 546 U.S at 56; F.T.C, v. Nat'l Bus. Consulants, Inc 376 F.3d 317, 322 (5<sup>th</sup> Cir, 2004) denied sub nom, 544 U.S 904 (2005)
41. Schaffer, 546 U.S at 58, Martinelli v.Bridgeport Roman Catholic Diocesan Corp., 196 F.3d 409.428.(2<sup>nd</sup> Cir 1999);
42. Schaffer, 546 U.S. at 56; Bristow, 41 F.3d at 353.
43. Schaffer,546 U.S at 56. Bristow v. Drake St. Inc, 41 F.3d 345, 353 (7<sup>th</sup> Cir. 1994) reh'g denied, 1995 U.S App. LEXIS 2063 (7<sup>th</sup> Cir 1995), Lisbon Constructors,828 F.2d at 765.
44. Schaffer,546 U.S at 56; More v. Kulicke & Soffa Indus., Inc., 318 F.3d. 561, 566 (3<sup>rd</sup> Cir 2003)
45. Stanley v. Illinois, 405 U.S. 645 (1972) (presumption that unwed fathers are unfit parents). But see Michael H. v. Gerald D., 491 U.S. 110 (1989) (statutory presumption of legitimacy accorded to a child born to a married woman living with her husband defeats the right of the child's biological father to establish paternity and visitation rights).
46. Sutton v Sadler [1857] EngR 738; (1857) 3 CB (NS) 87; 140 ER 671.
47. Thus, on the some day Murry was decided, a similar food stamp qualification was struck down on equal protection grounds. Department of Agriculture v. Moreno, 413 U.S. 528 (1973).
48. United States v. 15 Bosworth St., 236 F.3d 50, 55 (1<sup>st</sup> Cir 2001); In re Malget, 163 B.R. 933, 936 (Bank.S.D.Cal 1994).
49. Vanderbilt Law Review, "The Nature and Purpose of Evidence Theory", 2013,
50. Vlandis v. Kline, 412 U.S. 441 (1973).

## **Burimet nga Legjislacioni**

1. Kodi i Procedurës Cvile të Republikës së Shqipërisë
2. Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore
3. Ligji Nr. 2004/32, për Familjen i Kosovës
4. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Republikës së Kosovës.
5. Ligji nr. 03/L-154 për Pronësi dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës

## **Burimet nga interneti**

1. <https://businessandlegal.ie/evidence-in-civil-legal-actions-what-you-need-to-know>
2. <https://www.bc-llp.com/what-is-the-burden-of-proof-in-a-civil-case/>
3. Definition of Burden of Proof, page 12, September 26, 2010, <http://www.yourdictionary.com/burden-of-proof>.
4. <http://forpeopleforjustice.com/standards-of-proof-in-civil-cases/>
5. <http://www.abysinialaw.com/study-on-line/item/932-meaning-and-nature-of-evidence-law#>